



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.48

2004

15 korrik

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9236 datë 10.6.2004	Për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Nismën e Europës Qendrore (NEQ)	3325
Ligj nr.9237 datë 10.6.2004	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë për realizimin e programit “Periferitë urbane të Tiranës - komponenti infrastrukturor””	3333
Ligj nr.9238 datë 10.6.2004	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë për realizimin e programit “Rehabilitimi dhe pajisja e 5 poliklinikave””	3342
Ligj nr.9241 datë 10.6.2004	Për një ndryshim në ligjin nr.8677, datë 2.11.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”	3351
Dekret nr.4252 datë 1.7.2004	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare	3351
Vendim i KM nr.281, datë 16.4.2004	Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Korçës.....	3352
Vendim i KM nr.429, datë 2.7.2004	Për kalimin e portit të peshkimit, Shëngjin në administrim të ndërmarrjes së rritjes së midhjeve Sarandë	3353

Vendim i KM nr.430, datë 2.7.2004	Për disa shtesa në vendimin nr.392, datë 15.8.2002 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rrogozhinë-Elbasan, në qarkun e Elbasanit”.....	3355
Vendim i KM nr.431, datë 2.7.2004	Për kriteret e gradimit të oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve rezervistë	3357
Vendim i KM nr.435, datë 25.6.2004	Për kriteret dhe masën e kompensimit të ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, kur emërohet ose komandohet në detyrë jashtë vendbanimit të tij..	3359
Vendim i KM nr.438, datë 2.7.2004	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.43, datë 17.1.1998 të Këshillit të Ministrave "Për organizimin e panairove dhe të ekspozitave tregtare", të ndryshuar	3360
Vendim i shkurtuar nr.815, datë 10.6.2004	Për shpalljen të zhdukur të shtetasit Selim Banaj	3360

LIGJ
Nr.9236, datë 10.6.2004

PËR ANËTARËSIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË NISMËN E EUROPËS QENDRORE (NEQ)

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Miratohet anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në Nismën e Europës Qendrore (NEQ).

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4262, datë 8.7.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

UDHËZIME DHE KODI I PROCEDURËS SË NISMËS TË EUROPËS QENDRORE

I. PARIMET DHE OBJEKTIVAT

Neni 1

Nisma e Europës Qendrore është një forum rajonal për bashkëpunimin dhe konsultimin ndërmjet shteteve anëtare të saj.

Shtetet anëtare të Nismës së Europës Qendrore janë: Shqipëria, Austria, Bjellorusia, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Republika Çeke, Hungaria, Italia, Maqedonia, Moldavia, Polonia, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Ukraina, Republika Federale e Jugosllavisë.

Neni 2

Shtetet anëtare të Nismës së Europës Qendrore udhëhiqen nga parimet e Kartës së OKB-së, me të gjitha dokumentet e procesit të Helsinkit/OSBE. Ato udhëhiqen, gjithashtu nga deklaratat dhe dokumentet përfundimtare të mbledhjeve të kryetarëve të qeverive dhe të ministrave të jashtëm të Nismës së Europës Qendrore (përfshirë edhe nismat pararendëse si: katërpalëshe, pesëpalëshe, gjashtëpalëshe).

Neni 3

Nisma e Europës Qendrore si pjesë e procesit të integritetit evropian synon të bashkëpunojë me institucionet dhe organizatat europiane, veçanërisht me Bashkimin Evropian, Këshillin e Europës dhe OSBE-në, si dhe për kooperimin me nismat e tjera rajonale në zona me interes reciprok.

Nisma e Europës Qendrore, gjithashtu kooperon me sistemin e Kombeve të Bashkuara dhe me organizatat e tjera ndërkombëtare që kanë lidhje me çështjen, veçanërisht me Komisionin Ekonomik të OKB-së për Europën (UNECE), Organizatën për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), si dhe me institucionet financiare ndërkombëtare, veçanërisht, Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).

Neni 4

Synimet strategjike të Nismës së Europës Qendrore janë:

- Të punohet në drejtim të një Europe të bashkuar, pa ndarje, një Europë me vlera gjithëpërfshirëse për vendet, rajonet, popujt dhe qytetërimet e kontinentit.
- Përqendimin e bashkëpunimit brenda kornizës së Nismës së Europës Qendrore, veçanërisht në drejtim të forcimit të kapaciteteve të vendeve anëtare më pak të zhvilluara dhe atyre që kanë nevojën më të madhe për zhvillim të përshpejtuar ekonomik ose rimëkëmbje.

Neni 5

Bashkëpunimi brenda kornizës së Nismës së Europës Qendrore, do të synojë në objektivat kryesore të mëposhtme:

- Forcimin e bashkëpunimit midis dhe ndërmjet shteteve anëtare.
- Sigurimin e pjesëmarrjes të të gjitha shteteve anëtare në procesin e integritetit europian.
- Fuqizimin ekonomik, social, ligjor dhe aspekte të tjera të proceseve transformuese.

Neni 6

Bashkëpunimi brenda kornizës së Nismës së Europës Qendrore do të përfshijë "inter alia" çështjet e mëposhtme:

- Këshillimin mbi çështjet politike me interes reciprok;
- Bashkëpunimin ekonomik dhe teknik;
- Zhvillimin e infrastrukturës në transport, energji, telekomunikacion, bujqësi;
- Forcimin e institucioneve demokratike dhe respektimin e të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat e personave që u përkasin minoriteteve kombëtare, si dhe çështjeve humanitare;
- Mbrojtjen e mjedisit;
- Bashkëpunimin në fushën e shkencës dhe teknologjisë, medias, kulturës, arsimit, turizmit;
- Bashkëpunimin ndërkufitar dhe ndërrajonal.

II . ANËTARËSIMI DHE PJESËMARRJA NË NISMËN E EUROPËS QENDRORE

Neni 7

NEQ-i mund të ftojë çdo vend të tretë të interesuar, entitet rajonal ose organizatë ndërkombëtare, të marrë pjesë në aktivitetet e Nismës së Europës Qendrore, si dhe në ngjarjet, programet e projektet e saj.

NEQ-i mund të akordojë statusin e të ftuarit special ose të një forme tjetër të partneritetit të përshtatshëm.

Neni 8

NEQ-i do të nxisë bashkëpunimin me OJQ-të, shoqatat profesionale, institucione të tjera akademike që shprehen të gatshme të bashkëpunojnë në çështjet me interes të ndërsjellë.

Neni 9

Çdo shtet anëtar i NEQ-it, i cili shkel parimet e përmendura në nenin 4 të Kodit aktual mund të pezullohet nga e drejta e përfaqësimit nga ministrat e jashtëm. Në rast se këto vende anëtare nuk heqin dorë nga shkelja, kryetarët e qeverive mund të vendosin për t'u hequr të drejtën e të qenit anëtar i NEQ-it

Vendimmarrja në këtë kuadër bëhet në bazë të rregullit të konsensusit minus një votë.

III. ORGANIZIMI DHE STRUKTURA

Neni 10

NEQ-i vepron në mënyrë fleksible nëpërmjet organizmave të ndryshëm.

Neni 11

Dimensioni qeveritar i NEQ-it konsiston në organizmat e mëposhtme:

- Mbledhja e kryetarëve të shteteve (Samiti i Nismës së Europës Qendrore);
- Mbledhja e ministrave të punëve të jashtme;
- Mbledhja e drejtorëve politikë të ministrave të punëve të jashtme të vendeve anëtare të NEQ-it (Takimi i drejtorëve politikë);
- Komiteti i Koordinatorëve Kombëtarë;
- Organet e punës (Grupet e punës, grupet e ekspertëve, grupet e projektit etj.);
- Sekretariati Ekzekutiv;
- Si një instrument i specializuar Sekretariati për Projektet e NEQ-it (Sekretariati NEQ\BERZH).

Neni 12

Dimensioni parlamentar i NEQ-it funksionon në bazë të strukturave dhe rregullave të procedurës. Ai konsiston në organizmat e mëposhtëm:

- Konferenca e Kryetarëve të Parlamenteve;
- Asambleja Parlamentare;
- Komiteti Parlamentar;
- Organizmat e punës (Komitete *ad hoc* etj.).

Neni 13

Dimensioni tregtar i NEQ-it, i cili funksionon në bazë të modaliteteve të tij, konsiston në organizmat e mëposhtëm:

- Konferenca vjetore e kryetarëve të dhomave të tregtisë të Nismës së Europës Qendrore (CECCI);
- Sekretariati i konferencës vjetore të presidentëve të CECCI-t.

Neni 14

Mbledhja e kryetarëve të qeverive (Samiti i NEQ-it) do të bëhet një herë në vit, në vjeshtë. Samiti i nismës do të vendosë për çështjet që vijnë:

- Parimet dhe objektivat e NEQ-it;
- Modifikimet në “Udhëzimet dhe Kodi i Procedurës së NEQ-it”;
- Orientim politik dhe ekonomik për bashkëpunim në kuadrin e iniciativës, duke përfshirë adoptimin e planit për veprim;
- Pezullimi i anëtarësimit;
- Miratimi i raportit vjetor të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit Ekzekutiv.

Neni 15

Mbledhja e ministrave të punëve të jashtme do të bëhet 1 herë në vit, në pranverë. Mbledhja e ministrave të jashtëm do të vendosë për çështje specifike të bashkëpunimit të NEQ-it duke përfshirë:

- Bashkëpunimin politik;
- Pjesëmarrjen në aktivitetet e Nismës së Europës Qendrore, siç përmendet në nenin 7;
- Strukturat organizative, fushat dhe rrugët e bashkëpunimit;
- Çështjet që lidhen me vendosjen dhe strukturën operative të organeve të punës;
- Rregullat për kontributin, buxhetin dhe shkallën e kontributit vjetor të fondit të bashkëpunimit të NEQ-it;
- Përzgjedhjen dhe emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm dhe nëndrejtorëve të Sekretariatit Ekzekutiv të NEQ-it.

Neni 16

Mbledhja e drejtorëve politikë të ministrave të punëve të jashtme të vendeve anëtare të NEQ-it do të organizohet të paktën një herë në vit. Si rregull, ajo duhet të mbledhet në Romë. Mbledhje të tjera shitesë mund të bëhen në lidhje me situata specifike që mund të krijohen në rajonin e NEQ-it ose brenda organizatës.

Neni 17

Komiteti i Koordinatorëve Kombëtarë është organi kyç, përgjegjës për menaxhimin e bashkëpunimit të Nismës së Europës Qendrore dhe zbatimin e programeve të Nismës së Europës Qendrore dhe projekteve nëpërmjet strukturave përkatëse. Komiteti i Koordinatorëve Kombëtarë mbledhet rregullisht, parimisht një herë në muaj, për të diskutuar dhe për të koordinuar bashkëpunimin me organe të ndryshme të Nismës së Europës Qendrore, si dhe lidhjet me organizata të tjera dhe grupime rajonale.

Komiteti i Koordinatorëve Kombëtarë, i mbështetur nga Sekretariati Ekzekutiv i Nismës së Europës Qendrore, do të përgatisë dokumentet që do të aprovohen nga Samiti i Nismës së Europës Qendrore ose nga mbledhja e ministrave të punëve të jashtme.

Komiteti i Koordinatorëve Kombëtarë do të diskutojë dhe do të rishikojë aktivitetet e grupeve të punës së Nismës së Europës Qendrore dhe do t'u ofrojë atyre një orientim të përshtatshëm.

Komiteti i Koordinatorëve Kombëtarë, duke u konsultuar me Drejtorin e Përgjithshëm të Sekretariatit Ekzekutiv të NEQ-it do të vendosë mbi strukturën dhe stafin e Sekretariatit Ekzekutiv të Nismës.

Neni 18

Në rast nevojë, Komiteti i Koordinatorëve Kombëtarë mund t'i besojë detyra të posaçme një komiteti me anëtarë të reduktuar, që kanë të bëjnë, ndër të tjera edhe me çështje që lidhen me aspektin teknik dhe financiar të aktiviteteve të Nismës së Europës Qendrore, duke përfshirë ato që lidhen me bashkëpunimin me Bashkimin Europian/Këshillin e Europës dhe organizata të tjera ndërkombëtare dhe institucione financiare.

Sekretariati Ekzekutiv i NEQ-it dhe Sekretariati për projekte i NEQ-it do të marrin pjesë në takimet e këtij Komiteti.

Neni 19

Kryesia e Nismës së Europës Qendrore (Presidenca) do të zgjidhet me radhë në çdo fillim viti kalendarik, bazuar në radhën alfabetike të emrave anglisht të shteteve anëtare, në rast se Sekretariati Ekzekutiv nuk vendos ndryshe. (Në lidhje me organet e punës shiko nenin 18).

Presidenca e radhës do të mbështetet nga Presidenca e kaluar dhe ajo e ardhshme, të cilat formojnë Trojkën e NEQ-it.

Presidenca do të organizojë mbledhjen e kryetarëve të qeverive, të ministrave të jashtëm, të drejtorëve politikë dhe të Komitetit të Koordinatorëve. Kjo e fundit mund të organizohet edhe në vende të tjera. Në rast të mungesës së kryetarit të radhës, me aprovimin e Presidencës, takimet do të drejtohen nga një anëtar i Trojkës ose Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit Ekzekutiv.

Neni 20

Parimet dhe objektivat e bashkëpunimit të Nismës së Europës Qendrore do të përmbushen nëpërmjet aktiviteteve të përshtatshme të një strukture fleksibël të organeve të punës, mbledhjes së ekspertëve të nivelit zyrtar dhe ministerial.

Forma të ndryshme të grupeve të punës (ad hoc, grupet e punës së përhershme, grupet e ekspertëve dhe projekteve, organet këshillimore etj.) mund të propozohen, të ngrihen mbi iniciativën e një ose më shumë shteteve anëtare të Nismës së Europës Qendrore, vendosja e tyre, struktura dhe fusha e aktivitetit do të vendoset nga mbledhja e ministrave të punëve të jashtme mbi rekomandimet e Komitetit të Koordinatorëve Kombëtarë.

Si rregull i përgjithshëm një shtet anëtar duhet të sigurojë të paktën një kryesi ose një bashkëkryesi të grupeve të punës.

Shtetet anëtare të Nismës së Europës Qendrore, duke drejtuar një grup pune ose duke aplikuar për kryesi, do të prezantojnë për aprovim një draft pikash referimi, një draft programesh të aktiviteteve, si dhe kandidatë të kualifikuar për kryetarë të radhës së Nismës së Europës Qendrore. Ku shihet e përshtatshme mund të caktohet edhe një kryetar nga një tjetër shtet anëtar.

Grupet e punës do të mbështeten nga Sekretariati Ekzekutiv i Nismës së Europës Qendrore, si dhe nga Sekretariati për Projektet e Nismës së Europës Qendrore, në kryerjen e detyrës.

Në qoftë se një grup pune nuk kryen aktivitetet gjatë një viti kalendarik, Komiteti i Koordinatorëve Kombëtarë do të vendosë për masat përkatëse, përfshirë p.sh. rotacionin e adoptimit të kushteve të referencës ose të shpërbërjes.

Neni 21

Sekretariati Ekzekutiv i Nismës së Europës Qendrore është i vendosur në Trieste, Itali dhe do të kryesohet nga Drejtori i Përgjithshëm. Sekretariati Ekzekutiv i Nismës së Europës Qendrore, si një organ i përhershëm i Nismës do të sigurojë një mbështetje të vazhdueshme administrative dhe konceptuale ndaj strukturave vendimmarrëse dhe operationale të Nismës së Europës Qendrore dhe do të ndërmarrë iniciativat e duhura që synojnë nxitjen e realizimit të objektivave të bashkëpunimit të Nismës.

Detyra e Sekretariatit Ekzekutiv të Nismës së Europës Qendrore do të përfshijë ndër të tjera fushat e mëposhtme:

- informacionin dhe dokumentimin;
- organizimin, përgatitjen dhe takimet në vazhdimësi;
- pjesëmarrjen në takimet e Nismës së Europës Qendrore;
- projektet dhe programet e Nismës së Europës Qendrore.

Sekretariati Ekzekutiv i Nismës së Europës Qendrore do të kryejë, gjithashtu dhe detyra të tjera që do t'i caktohen nga Samiti i Nismës së Europës Qendrore, takimet e ministrave të jashtëm, kryetari i radhës dhe Komiteti i Koordinatorëve Kombëtarë të Nismës së Europës Qendrore.

Struktura dhe stafi i Sekretariatit Ekzekutiv të Nismës së Europës Qendrore do të vendoset nga Komiteti i Koordinatorëve Kombëtar në konsultim me Drejtorin e Përgjithshëm. Struktura dhe

aktiviteti i Sekretariatit Ekzekutiv të Nismës së Europës Qendrore, veçanërisht në fushën e personelit dhe financës do të jetë në përputhje me ligjin e shtetit pritës. Gjatë kryerjes së detyrave të tij Sekretariati Ekzekutiv i Nismës së Europës Qendrore do të bashkëpunojë me Koordinatorët Kombëtarë, kryetarët e organeve të punës, personat dhe subjektet e tjera, të cilët janë përfshirë në aktivitetet e Nismës së Europës Qendrore.

Autoritetet e shtetit pritës do të financojnë aktivitetet e Sekretariatit Ekzekutiv të Nismës së Europës Qendrore, si dhe pagat e stafit. Shtetet anëtare që caktojnë zyrtarët e stafit (përfshirë Drejtorin e Përgjithshëm) do të mbulojnë shpenzimet respektive. Shtetet anëtare të Nismës së Europës Qendrore do të ofrojnë vullnetarisht burime financiare e materiale për aktivitetet e Sekretariatit Ekzekutiv të Nismës së Europës Qendrore.

Neni 22

Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit Ekzekutiv të Nismës së Europës Qendrore do të caktohet ndërmjet kandidatëve të caktuar nga shtetet anëtare të Nismës së Europës Qendrore dhe do të zgjidhet/thirret nga takimi i ministrave të jashtëm në bazë të rekomandimit të Komitetit të Koordinatorëve Kombëtarë. Mandati i tij/saj do të zgjasë për tre vjet, duke pasur të drejtën e rizgjedhjes për një periudhë tjetër trevjeçare.

Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit Ekzekutiv të Nismës së Europës Qendrore do të marrë pjesë në Samitin e Nismës së Europës Qendrore, takimin e ministrave të jashtëm, takimet e Komitetit të Koordinatorëve Kombëtarë, takimet e grupeve të punës në nivel ministerial, Komitetin e Përhershëm të Sekretariatit për projektet e Nismës së Europës Qendrore dhe në aktivitetet e tjera të rëndësishme të Nismës.

Në bashkëpunim me kryetarin e radhës, Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit Ekzekutiv të Nismës së Europës Qendrore ose përfaqësuesin e tij/saj do të marrin pjesë në emër të Nismës së Europës Qendrore, në aktivitetet përkatëse të organizatave dhe institucioneve të tjera europiane dhe ndërkombëtare.

Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Nismës së Europës Qendrore do të përgatisë një raport vjetor mbi aktivitetet e Sekretariatit Ekzekutiv të Nismës së Europës Qendrore përfshirë aspektet financiare, të cilat do të jenë subjekt i pranimi nga takimi i ministrave të jashtëm në bazë të rekomandimit të Komitetit të Koordinatorëve Kombëtarë.

Neni 23

Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit Ekzekutiv asistohet nga dy nëndrejtorë të përgjithshëm. Drejtori i Përgjithshëm dhe nëndrejtorët përfaqësojnë nivelin ekzekutiv të Sekretariatit të NEQ-it.

Një nga postet e nivelit ekzekutiv do t'i akreditohet vendit që pret aktivitetet. Nëndrejtorët do të përzgjidhen mes kandidatëve të propozuar nga vendet anëtare të NEQ-it dhe do të emërohen në detyrë në takimin e ministrave të jashtëm në bazë të rekomandimeve të Komitetit të Koordinatorëve Kombëtar. Mandati i detyrës së nëndrejtorëve është 3 vjet dhe mund të ripërtërihet dhe një herë për një periudhë kohore trevjeçare.

Neni 24

Për funksionimin e marrëveshjeve në të cilat ai bazohet, Sekretariati për projektet e Nismës së Europës Qendrore (Sekretariati i NEQ/BERZH) merr përsipër detyrat që synojnë kryesisht në projektet e investimit dhe në fushat e mëposhtme:

- bashkëpunimi ekonomik;
- menaxhimi i fondit të Nismës së Europës Qendrore dhe mobilizimi i burimeve financiare;
- nxitja, indentifikimi dhe përgatitja e dhënies së ndihmës për projektet e investimeve;
- mbështetja teknike për projektet e investimeve;

- mbështetja për zhvillimin e sistemit dhe programin institucional (p.sh. organizimi i aktiviteteve ndërkombëtare, trajnimeve, shërbimeve këshillimore dhe sistemeve të informacionit).

Sekretariati për Projektet e Nismës së Europës Qendrore është i lidhur nga pikëpamja institucionale me Sekretariatit Ekzekutiv të Nismës së Europës Qendrore dhe e ka qendrën në Sekretariatit Ekzekutiv të Nismës së Europës Qendrore në Trieste, Itali, duke mbajtur gjithashtu një zyrë të përhershme, në BERZH, Londër.

Komiteti i Koordinatorëve Kombëtarë, së bashku me drejtorët që përfaqësojnë shtetet anëtare në Bordin e Drejtorëve të Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, përbëjnë Komitetin e Përhershëm të Sekretariatit për Projektet e Nismës së Europës Qendrore.

Neni 25

Bashkëpunimi mes dimensionit qeveritar dhe atij parlamentar do të drejtohen nga modalitetet e mëposhtme:

- Një sesion i përbashkët në nivel Ministrash të Punëve të Jashtme të Trojkës së zgjeruar¹ të NEQ-it dhe të Trojkës së zgjeruar të Komitetit të Parlamentarëve të NEQ-it do të organizohet me rastin e takimit të ministrave të jashtëm në mënyrë që të sigurohet një debat i gjerë mbi objektivat strategjike dhe sfidat e NEQ-it, si dhe për kontributet që do të japë dimensionit parlamentar për të gjithë punën e organizatës.

- Presidenca e dimensionit parlamentar të NEQ-it do të ftohet të marrë pjesë me të drejtën e pjesëmarrjes në debat në të gjitha mbledhjet e nivelit të lartë të organizuar nga NEQ-i.

- Kryetarët e grupeve të punës së NEQ-it dhe të komiteteve përkatëse ad hoc të dimensionit parlamentar të NEQ-it do të punojnë së bashku, do të shkëmbejnë informacionin mbi programet e ndërsjella të punës dhe në çdo sesion të tyre një pikë e axhendës do t'i kushtohet këtij bashkëpunimi.

- Menjëherë pas çdo takimi të fundvitit të Komitetit të Koordinatorëve Kombëtarë do të organizohet një takim njëditor me pjesëmarrjen e Trojkës së zgjeruar në nivel Koordinatorësh Kombëtarë, të dimensionit parlamentar në nivel të përshtatshëm, CECCI-it në nivel të përshtatshëm, Sekretariatit Ekzekutiv dhe Sekretariatit të BERZH-it me qëllim analizimin e punës për vitin në mbarim dhe harmonizimin e aktiviteteve për vitin e ardhshëm.

- Bashkëpunimi me dimensionin parlamentar nuk do të prekë vendimet që kanë të bëjnë me çështje financiare të marra nga qeveritë e vendeve anëtare të NEQ-it ose të Sekretariatit të Nismës.

Neni 26

Bashkëpunimi ndërmjet dimensionit qeveritar dhe atij të biznesit do të drejtohen nga modalitetet e mëposhtme.

- Presidenca e CECCI-it do të ftohet të marrë pjesë në të gjitha takimet e nivelit të lartë të NEQ-it, si dhe në ato takime të grupeve të punës që kanë interes për CECCI-in.

- Presidenca e CECCI-it do të ftohet të marrë pjesë në aktivitetet me interes të Presidencës apo Trojkës së NEQ-it.

- Menjëherë pas çdo takimi të fundvitit të Komitetit të Koordinatorëve Kombëtarë do të organizohet një takim njëditor me pjesëmarrjen e Trojkës së zgjeruar në nivel Koordinatorësh Kombëtar, të dimensionit parlamentar në nivel të përshtatshëm, CECCI-it në nivel të përshtatshëm, Sekretariatit Ekzekutiv dhe Sekretariatit të BERZH me qëllim analizimin e punës për vitin në mbarim dhe harmonizimin e aktiviteteve për vitin e ardhshëm.

- Strukturat e CECCI-it në vendet anëtare të NEQ-it do të bashkëpunojnë ngushtë në promovimin dhe organizimin e Samitit të Forumit Ekonomik të NEQ-it, duke organizuar aktivitetet promovuese dhe sesione të Samitit të Forumit Ekonomik në nivel kombëtar.

- Bashkëpunimi me CECCI-in nuk do të prekë vendimet që kanë të bëjnë me çështje financiare të marra nga qeveritë e vendeve anëtare të NEQ-it ose të Sekretariatit të Nismës.

¹ Trojka e zgjeruar përbëhet nga Trojka e NEQ-it plus vendi mikpritës

IV. PROCEDURA E VENDIMMARRJES

Neni 27

Në bazë të dispozitave të nenit 9 dhe 16, vendimet brenda Nismës së Europës Qendrore merren me konsensus si një rregull i përgjithshëm.

Konsensusi duhet kuptuar si mungesë e ndonjë kundërshtimi të shprehur nga një shtet anëtar, meqë paraqitet prej tij si një pengesë në marrjen e vendimit në fjalë.

Çështjet që kanë të bëjnë me anën procedurale duhet të vendosen nga një shumicë e thjeshtë nga një vend anëtar.

V. AFTËSIA LIGJORE

Neni 28

Angazhime të përbashkëta të iniciativës me një karakter ligjor në lidhje me palët e treta nënshkruhen në emër të Nismës së Europës Qendrore nga Presidenca e Nismës së Europës Qendrore dhe Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit Ekzekutiv të Nismës së Europës Qendrore.

VI. FINANCIMI

Neni 29

Secili vend anëtar është përgjegjës për financimin e shpenzimeve të tij që lidhen me aktivitetet e Nismës së Europës Qendrore. Si rregull shpenzimet që rrjedhin nga organizimi i takimeve do të mbulohen nga vendi pritës. Shtetet anëtare do të lehtësojnë zbatimin e programeve dhe projekteve të Nismës së Europës Qendrore përmes kontributeve vjetore financiare. Modalitetet përkatëse për zbatimin e kësaj dispozite do të përcaktohen në rregulloret që do të aprovohen nga takimi i ministrave të jashtëm. Me qëllim që të lehtësohet pjesëmarrja e të gjitha shteteve anëtare në aktivitetin e Nismës së Europës Qendrore dhe të sponsorizuara nga nisma do të jepet një ndihmë për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe të akomodimit përmes fondit të solidaritetit, të menaxhuara nga Sekretariati Ekzekutiv i Nismës së Europës Qendrore, në përputhje me orientimet e fondit të solidaritetit, aprovuar nga Komiteti i Koordinatorëve Kombëtarë.

VII. FLAMURI DHE GJUHA

Neni 30

Flamuri i Nismës së Europës Qendrore përfaqëson një fushë blu me logon zyrtare të Nismës. Logoja i Nismës së Europës Qendrore përbëhet nga një grup shkronjash “CEI” me një transkriptim bllok “Central European Initiative”, e rrethuar me një gjysmërreth i përbërë nga 10 yje të verdhë.

Neni 31

Gjuha e punës e Nismës së Europës Qendrore është anglishtja. Dokumentet e Nismës përpilohen në gjuhën angleze.

Në qoftë se një pjesëmarrës në një aktivitet të Nismës së Europës Qendrore dëshiron që të përdorë një gjuhë tjetër, ai duhet të marrë përsipër përkthimin.

VIII. NDRYSHIMI I ORIENTIMEVE TË NISMËS SË EUROPËS QENDRORE

Neni 32

Çdo amendament i propozuar nga një shtet anëtar do të shqyrtohet nga Komiteti i Koordinatorëve Kombëtarë. Në qoftë se bie dakord, Komiteti i Koordinatorëve Kombëtarë do të paraqesë një rekomandim për aprovim në takimin e kryetarëve të qeverive.

Vërtetohet se përkthimi i Kodit të Procedurave dhe udhëzimet për funksionimin e NEQ-it në gjuhën shqipe është i njëjtë me origjinalin e tij në gjuhën angleze.

LIGJ

Nr.9237, datë 10.6. 2004

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË ITALISË PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT “PERIFERITË URBANE TË TIRANËS - KOMPONENTI INFRASTRUKTUROR””

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë për realizimin e programit “Periferitë urbane të Tiranës - komponenti infrastrukturor””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4263, datë 8.7.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ITALISË PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT “PERIFERITË URBANE TË TIRANËS – KOMPONENTI INFRASTRUKTUROR”

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit (MRRT&T) dhe Qeveria e Republikës së Italisë, e përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, Drejtoria e Përgjithshme e Kooperacionit për Zhvillim (MAE-DGCS), në vijim të quajtura “Palët Kontraktuese”,

duke qenë se në protokollin e bashkëpunimit për trevjeçarin 1998-2000, kooperacioni italian impenjohet në financimin e ndërhyrjeve në fushën e dy veprave të urbanizimit primar në zonat periferike të Tiranës dhe të Vlorës, të emëtuara:

- Ribërja e shërbimeve esenciale të Tiranës dhe të Vlorës,
- Periferitë urbane të Tiranës – komponenti infrastrukturor;

duke qenë se gjatë mbledhjes së datës 23.4.1999, Komiteti Drejtues i MAE-DGCS miratoi një financim grant prej 7 100 000 000 lireta në favor të ndërhyrjes së parë: “Ribërja e shërbimeve esenciale Tiranë –Vlorë”;

duke qenë se kjo ndërhyrje është aktualisht në fazën e realizimit dhe përfshin edhe financimin e një PIU (Njësia e Zbatimit të Projektit), e ngritur pranë MRRT&T për të siguruar menaxhimin e të dyja ndërhyrjeve;

duke qenë se në protokollin e bashkëpunimit 2002-2004, të nënshkruar më 9 prill 2002, u konfirmua impenjimi për financimin e ndërhyrjes së dytë të lartpërmendur;

duke qenë se në mbledhjen e datës 21.1.2003, Komiteti Drejtues i MAE-DGCS është shprehur në favor të dhënies së një kredie ndihme prej 3 000 000 euro për realizimin e ndërhyrjes “Periferitë urbane të Tiranës – komponenti infrastrukturor”, në vijim i quajtur programi;

duke marrë në konsideratë sa më lart,

Palët Kontraktuese ranë dakord sa më poshtë vijon:

Neni 1

Qëllimi dhe pjesët e Marrëveshjes

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është të rregullojë detyrimet reciproke të të dyja Palëve për zbatimin korrekt të programit, në mënyrë të veçantë kundrejt modaliteteve të vlerësimit të kontratave, si dhe atyre të menaxhimit/përgjegjësisë /livrimit të fondeve të kredisë së ndihmës.

Kjo Marrëveshje është e përbërë nga 14 nene dhe nga 3 shtojca bashkëngjitur, që janë pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje:

1. Sintezë e programit;
2. Tenderat e shërbimeve, livrimeve dhe punimeve (Kushte të veçanta-specifikimet);
3. Modaliteti i zbatimit dhe menaxhimit të kredisë së ndihmës.

Neni 2

Objektivat e programit

Programi paraqet ndërhyrje të menjëhershme infrastrukturore dhe rivlerësim urbanistik, me qëllim që t’u garantojë banorëve të zonave të interesuara një përmirësim të shpejtë të cilësisë së jetesës dhe një menaxhim më të mirë të shërbimeve urbane.

Neni 3

Përshkrimi i programit

Programi është përshkruar shkurtimisht në shtojcën 1 dhe parashikon të arrijë rezultatet e mëposhtme, relativisht në zonën e ndërhyrjes (zona e Laprakës në Tiranë):

- lidhja me rrjetin hidrik të qytezës së të gjitha banesave të zonës;

- kompletim të rrjetit të kanalizimeve për heqjen e ujërave të zeza urbane;
- rrugë të mira për këmbësorët dhe për automjetet në rrjetin e brendshëm rrugor dhe në hyrje/dalje të zonës;
- ndriçim të mirë publik të rrugëve dhe të hapësirave të përbashkëta;
- disponueshmëri dhe përdorshmëri të hapësirave publike të hapura dhe të mbyllura (biblioteka, qendra sociale, zona të verdha).

Zbatimi i programit përmban aktivitetin e projektimit, ndërtimit dhe të supervizionimit të punimeve, që do të realizohen nëpërmjet procedurave të tenderit të rezervuara për shoqëritë italiane.

Neni 4

Institucione të përfshira në realizimin e programit

Institucionet e përfshira në realizimin e programit janë si më poshtë:

Për Palën shqiptare:

- a) MRRT&T, që do të sigurojë zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja prezente, duke përfshirë, nëse është e nevojshme, strukturat e tjera qeverisëse kompetente shqiptare.
- b) Ministria e Financave (MF), që do të ndjekë Konventën financiare me MCC-në dhe kontaktet operative me këtë të fundit dhe me bankat agjente siç është precizuar në Konventën financiare.
- c) PIU, pranë MRRT&T që do të sigurojë koordinimin e të gjitha funksioneve të natyrës teknike dhe menaxheriale të nevojshme për realizimin e programit.

Për Palën italiane:

- a) MAE/DGCS, që do të sigurojë livrimin e burimeve financiare për kredinë, sipas modaliteteve të parashikuara nga dispozitat ligjore italiane në fuqi, sintetikisht të dhëna në Marrëveshjen prezente. MAE/DGCS në bashkëpunim me Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, do të ketë, përveç të tjerash, detyrën për të monitoruar ecurinë e programit dhe kapacitetin e tij për të arritur rezultatet e dhëna në nenin 3. MAE/DGCS do të veprojë nëpërmjet zyrave kompetente për zbatimin e detyrave të saj. Në veçanti, Njësia Teknike Qendrore MAE/DGCS, më poshtë e quajtur NJTQ, do të sigurojë të gjitha funksionet e natyrës teknike për të mbështetur realizimin e programit.
- b) Mediocredito Centrale (MCC), e cila - sipas instruksioneve të MAE/DGCS dhe të Ministrisë së Ekonomisë Italiane - do të hartojë me Ministrinë e Financave të Shqipërisë një Konventë financiare të lartpërmendur, MCC-ja do të ndjekë zbatimin e kontratave të veçanta për livrimin e mallrave, shërbimeve dhe punimeve, nëpërmjet të cilave do të realizohen aktivitetet e parashikuara në program. Përveç të tjerash, do të jetë nën kujdes të MCC-së që të sigurojë pagesën e kontraktimeve respektive për organizmat zbatues.
- c) Ambasada/UTL në Tiranë, që do të sigurojë të gjitha funksionet e natyrës teknike të nevojshme për supervizionin korrekt të ecurisë së aktiviteteve. Në kuadër të aktiviteteve institucionale Ambasada/UTL do të sigurojë, përveç të tjerash, dhe kontaktet e nevojshme me kundërpalën e programit, duke ndjekur marrjen dhe përcjelljen e të gjithë dokumentacionit zyrtar.

Neni 5

Burimet financiare dhe modalitetet e përdorimit të kredisë për ndihmë

Burimet financiare të nevojshme për realizimin e programit janë si më poshtë:

1. Kredi ndihme në shumën 3 000 000 euro për realizimin e të gjitha aktiviteteve të parashikuara në program.
2. Fondet e Qeverisë shqiptare, të barasvlefshme me rreth 600 000 euro për kostot lokale (TVSh-në, taksat doganore dhe ato portuale).

Termat dhe kushtet e kredisë së ndihmës janë si më poshtë:

- | | |
|--|---------|
| - Periudha e rimbursimit të kredisë: | 38 vjet |
| - Periudha e mospagimit të interesave (për rimbursimin e kredisë): | 17 vjet |
| - Taksa vjetore e interesit: | 0,10% |

Në bazë të procedurave në fuqi të MAE/DGCS, hapat kryesore për t'u ndërmarrë, për përdorimin e fondeve të kredisë së ndihmës, janë si më poshtë (më mirë specifikuar në shtojcën 3):

1. Nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje;
2. Nxjerrja nga ana e Ministrisë së Ekonomisë Italiane të një dekreti ministror që autorizon MCC-në, për të negociuar dhe nënshkruar Konventën financiare me MF-në;
3. Firmosja e Konventës financiare midis MCC dhe MF;
4. Përgatitja e dokumenteve të tenderit për besimin e shërbimeve inxhinierike (projektimi dhe supervizimi i punimeve);
5. Zhvillimi i tenderit dhe vlerësimi i ofertave relative nga ana e komisionit të vlerësimit i krijuar nga MRRT&T;
6. Verifikimi i konformitetit nga ana e MAE/DGCS i procedurave të tenderit dhe i llojit të kontratës për t'u lidhur dhe, në rast të përfundimit pozitivisht, specifikimi i kontratës nga ana e MRRT&T;
7. Përgjegjësia e kontratës nën Konventën financiare me modalitetet e livrimit të fondeve të dhëna në shtojcën 3;
8. Për dhënien e kontratave të zbatimit të punimeve do të përsëritet – mbas përfundimit të projektimit- procedura e dhënë në pikat precedente 6 dhe 7.

Neni 6

Monitorimi i programit

Ecuria e programit do të monitorohet gjatë gjithë kohës nga MAE/DGCS (nëpërmjet misionëve periodike të funksionarëve dhe ekspertëve të përcaktuar të fushës) dhe nga MRRT&T. Të dyja palët do të angazhohen që tani, të përcaktojnë të gjitha masat të cilat konsiderohen të nevojshme të merren gjatë zbatimit të programit, në rast se nuk janë respektuar skemat e treguesve ose nëse konsiderohet e papërshtatshme për kushtet sektoriale dhe lokale.

Neni 7

Modalitetet e tenderave të shërbimeve, livrimeve dhe punimeve

Përcaktimi i zbatuesve të aktiviteteve të programit do të verifikohet menjëherë mbas zhvillimit të tenderave që rregullohen sipas dispozitave që janë pjesë përbërëse e Manualit të Procedurave (i përshtatur nga Komisioni European në 23 dhjetor 2002) lidhur me:

“Tenderat e shërbimeve, livrimeve dhe punimeve në kuadër të bashkëpunimit komunitar me vendet e treta” siç është precizuar në shtojcën 2.

Neni 8

Detyrimet e Qeverisë italiane

Qeveria italiane impenjohet të garantojë financimin e 3 000 000 euro si kredi ndihme.

Fondi i kredisë së ndihmës do të bëhet i disponueshëm nëpërmjet MCC-së dhe do të livrohet siç është përcaktuar në shtojcën 3.

Neni 9

Detyrimet e Qeverisë shqiptare

Qeveria shqiptare impenjohet:

- të vërë në dispozicion burimet financiare përkatëse, të barasvlefshme me rreth 600 000 euro ose monedhë të barasvlefshme;
- të bëjë operative të gjitha veprimet, aktivitetet dhe aktet formale të nevojshme për një zbatim me sukses të programit;
- të bashkëpunojë me MAE/DGCS për aktivitetin e monitorimit të programit, dhe në bazë të nenit 6 të krijojë akses edhe për dokumentacionin ekzistues, dhe në zonat e aktiviteteve.

Neni 10

Zgjidhjet e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve Kontraktuese, lidhur me interpretimin dhe aplikimin e kësaj Marrëveshjeje, do të zgjidhet, për sa është e mundur, nëpërmjet konsultimeve dhe negociatave.

Neni 11

Pengesa dhe forca madhore

Në rast të pengimit të realizimit të programit, për shkak të forcave madhore (luftë, përmytje, zjarr, tufan, tërmet, konflikt pune, greva, masa të qeverive respektive, paparashikime gjatë transportit dhe shkaqe të tjera) të njohura si të tilla nga të dyja Palët, ose në rast rreziku, ose kushte të rrezikshme për personelin e huaj, do të zbatohen dispozitat në vazhdim, të bazuara në rekomandimet e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe të miratuara nga MAE/DGCS:

a) në rast se kohëzgjatja e pengimit të realizimit të programit është më pak se gjashtë muaj, përdorimi i fondeve të papërdorura do të pezullohet deri sa MAE/DGCS do të autorizojë rifillimin e aktiviteteve;

b) në rast se kohëzgjatja e pengesës është më shumë se gjashtë muaj dhe më pak se njëzet e katër muaj, programi pezullohet dhe fondet e papërdorura do të mbahen, derisa të mos ketë pengesa dhe të merret autorizimi i MAE/DGCS për fillimin e punimeve;

c) në rast se kohëzgjatja e pengesës është më e madhe se njëzet e katër muaj, Palët janë të detyruara të bien dakord mbi vazhdimësinë e programit dhe të përcaktojnë planin e veprimeve. Në rast se është e pamundur vazhdimi i aktivitetit, Palët duhet të vendosin për destinacionin e fondeve të papërdorura.

Neni 12

E drejta e zgjidhjes së Marrëveshjes të MAE/DGCS

MAE/DGCS ruan të drejtën e tërheqjes nga Marrëveshja në rastet e mëposhtme:

a) Mosrealizim i aktiviteteve të parashikuara në program, për arsye që nuk i atribuohen Palës italiane.

b) Pengesa të vazhdueshme ose forca madhore në bazë të nenit 11 si më sipër. Në të dyja rastet e përmendura më lart, MAE/DGCS mund të vendosë unanimisht përfundimin e Marrëveshjes, duke njoftuar dhe MRRT&T nëpërmjet një note verbale të paktën tre muaj përpara. Për çdo rast, pas një njoftimi të tillë, MRRT&T duhet të ndërpresë aktivitetin e programit, përveç kur Palët bien dakord ndryshe.

Neni 13

Modifikime

Palët në çdo moment mund të propozojnë modifikime të përmbajtjes së Marrëveshjes prezente me anë të shkëmbimit të notave verbale, nëpërmjet rrugëve diplomatike. Modifikimet e kryera në këtë mënyrë do të hyjnë në fuqi me anë të të njëjtave procedura që parashikohen në këtë Marrëveshje për hyrjen e kësaj të fundit në fuqi.

Neni 14

Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe denoncimi

Marrëveshja prezente do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të dytë nga dy njoftimet me të cilat Palët Kontraktuese do të komunikojnë zyrtarisht përfundimin e procedurave të brendshme respektive, sipas qëllimit të parashikuar.

Marrëveshja prezente ka një kohëzgjatje prej tre vjetësh. Në kohën e përfundimit të afatit, nëse aktivitetet e programit nuk kanë mbaruar, Palët mund të bien dakord për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Marrëveshjes prezente, e kufizuar në përdorimin e importit të mallrave për këtë qëllim, nëpërmjet rrugëve diplomatike.

Kjo Marrëveshje mund të denoncohet në çdo kohë kur shfaqen situatat e parashikuara në nenin 12. Denoncimi do të jetë efektiv mbas 60-ditësh, mbas njoftimit të Palës tjetër Kontraktuese.

Hartuar në Tiranë, më 29.1.2004 në dy origjinale, secila në gjuhën italiane dhe atë shqipe.

Në rast mospërputhjeje të përkthimit, do të ketë vlefshmëri teksti në gjuhën italiane.

Në bazë të sa më sipër, përfaqësuesit e nënshkruar, të autorizuar nga qeveritë respektive, firmosën këtë Marrëveshje.

PËR QEVERINË
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit
Bashkim Fino

PËR QEVERINË
E REPUBLIKËS SË ITALISË
Ambasadori i Republikës së Italisë
Attilio Massimo Iannucci

Shtojcë nr. 1

SINTEZË E PROGRAMIT

OBJEKTIVAT

Objektivat e përgjithshëm të programit përputhen me direktivat e kohëve të fundit të Qeverisë shqiptare, të finalizuara për një përmirësim të shpejtë të cilësisë së jetesës në qytete, ndërhyrje e menjëhershme infrastrukturore dhe rivlerësim urbanistik, si dhe për një menaxhim më të mirë dhe më të qëndrueshëm të shërbimeve urbane.

Më në veçanti, objektivat e përgjithshëm janë:

- i) të garantojë një përmirësim të kushteve të jetës në zonat periferike të Tiranës;
- ii) të rrisë kohëzgjatjen e infrastrukturave publike;
- iii) të ulë kostot operative të shërbimeve publike dhe të përmirësojë kohën e lëvizjes së mjeteve të motorizuara të transportit;
- iv) të përmirësojë kushtet sanitare të zonave periferike dhe si rrjedhojë të ulë shpenzimet sanitare dhe të rrisë produktivitetin e fuqisë së punës;
- v) të ulë përqindjet e aksidenteve.

Objektivat specifikë janë:

- i) të sigurojë furnizimin e ujit në zonën pilot të Laprakës;
- ii) të garantojë heqjen e ujërave të zeza në zonë;
- iii) të përmirësojë kushtet e rrugëve dhe të trotuareve;
- iv) të garantojë ndriçimin e rrugëve dhe të zonave publike, të garantojë frytshmërinë e hapësirave të përbashkëta.

REZULTATET E PRITSHME

Programi parashikon vepra infrastrukturore të urbanizimit primar, në gjendje për të siguruar rezultatet në vijim:

- a) Lidhja me rrjetin hidrik të qytezës të të gjitha banesave të zonës, duke garantuar në këtë mënyrë disponueshmërinë e ujit sipas standardeve europiane;
- b) Kompletimi i rrjetit të kanalizimeve për heqjen e ujërave të zeza urbane;
- c) Përmirësim i rrugëve, si për këmbësorët, ashtu dhe për automjetet, në rrjetin e brendshëm rrugor dhe në hyrje/dalje të zonës;
- d) Ndriçim i mirë publik i rrugëve dhe i hapësirave të përbashkëta;

e) Përdorim i mirë dhe disponueshmëri e hapësirave publike të hapura dhe të mbyllura (biblioteka, qendra sociale, zona të verdha).

AKTIVITETE PËR T'U KRYER NË VIJIM TË REZULTATEVE

Për secilin nga rezultatet e dhëna më sipër, parashikohet realizimi i aktiviteteve të mëposhtme:

a) rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit hidrik të zonës, i dimensionuar në mënyrë të përshtatshme dhe me lidhje aktive me të gjitha banesat;

b) rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të kanalizimeve të zonës, i dimensionuar në mënyrë të përshtatshme, me lidhje në rrjetin kryesor;

c) rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të brendshëm rrugor dhe i hyrjes/daljes nga zona duke ndërtuar dhe trotuare;

d) rehabilitimi dhe zgjerimi i sistemit të ndriçimit publik të rrugëve dhe të zonave të përbashkëta;

e) rehabilitimi i dy ndërtesave publike ekzistuese (kinemaja dhe biblioteka).

Shtojcë nr.2

TENDERAT E SHËRBIMEVE, LIVRIMEVE DHE PUNIMEVE (KUSHTE TË VEÇANTA)

Shtojca prezente i referohet përdorimit të kredisë së ndihmës italiane

Dhënia e kontratave do të kryhet nëpërmjet tenderave të hapur, të rezervuar vetëm për shoqëri italiane. Përqindja e kredisë së ndihmës e përdorshme për kosto lokale dhe/ose për vende drejt zhvillimit nuk mund të kalojë 40% të vetë kredisë.

Për dhënien e të gjithë tenderave të parashikuar në program, zbatohen procedurat e parashikuara në Manualin e Procedurave (i përshtatur nga Komisioni Europian në 23 dhjetor 2002) relativ me: tenderat e shërbimeve, livrimeve dhe punimeve në kuadër të bashkëpunimit komunitar me vendet e treta.

Në çdo rast procedura e seleksionimit duhet të përfshijë:

1. Verifikimi i përputhshmërisë së ofertave (persona juridikë, shoqëri dhe ndërmarrje), që nuk kategorizohen si më poshtë:

a) Janë në gjendje falimentimi, likuidimi, administrimi të kontrolluar ose me preventiv të koordinuar, ndërprerje aktiviteti ose që janë objekt i një procedimi të ngjashëm i parashikuar nga ligjet dhe rregullat kombëtarë;

b) Janë objekt i një procedure për deklarim falimentimi, likuidimi, administrimi të kontrolluar, preventiv i konkorduar ose të një procedimi të ngjashëm të parashikuar nga ligjet dhe nga rregullat kombëtarë;

c) Janë dënuar me vendim të prerë pa të drejtë apeli për shkelje të etikës profesionale;

d) Janë deklaruar përgjegjës për shkelje të rënda të detyrave profesionale, të provuara me elemente të çfarëdolloj dokumentacioni të administratës gjyqësore;

e) Nuk kanë bërë derdhje të rregullta të detyrimit të sigurimeve shoqërore sipas dispozitave ligjore të vendit ku janë permanente;

f) Nuk kanë bërë derdhje të rregullta të detyrimeve ligjore mbi taksat sipas dispozitave ligjore të vendit ku janë permanente;

g) Janë shpallur fajtorë për pasaktësi, lidhur me dhënien e informacionit të kërkuar nga administrata juridike lidhur me sa më sipër;

h) Janë shpallur fajtorë, për shkak të mosrespektimit të detyrimeve kontraktuale, të mospërbushjeve të rënda në lëndën e zbatimit, në kuadër të një kontrate tjetër të nënshkruar me të njëjtën administratë juridike ose në kuadër të një kontrate tjetër të financuar nëpërmjet fondeve komunitare.

Përveç kësaj ofertuesve italianë do t'u duhet të paraqesin një certifikatë ose një deklaratë të ngjashme që nuk bëjnë pjesë në kategoritë e dhëna në Dekretin Legjislativ Italian (8.8.1994, nr.490 -"antimafia"-)

Ofertuesit duhet të paraqesin, në mbështetje të ofertave të tyre, provat e duhura konform legjislacionit të vendit ku janë permanent, që vërteton se ata nuk janë ndodhur në asnjë nga situatat e parashikuara në pikat a, b, c, e dhe f.

2. Verifikimi i gjendjes ekonomike dhe financiare të ofertuesve, nëpërmjet:

a) një deklaratë të kapitalit social të shoqërisë dhe faturimeve, në tre vitet e fundit paraardhëse të tenderit;

b) një deklaratë të xhiros totale të konkurruesve, në rast se një *joint venture* të përkohshme të xhiros të secilit prej pjesëmarrësve;

c) një deklaratë që tregon xhiron e sektorëve specifikë, për të cilët referohet dhe në tender ose sektorin për të cilin, në rast të një asocimi të përkohshëm, shoqëria individuale synon të kontribuojë;

d) një deklaratë të përshtatshme e përfaqësuesve ligjorë ose një certifikatë bankare që përmban informacion mbi marrëdhëniet me institucionet bankare me rëndësi ndërkombëtare për të demonstruar pranueshmërinë komerciale dhe financiare të konkurruesve dhe të shoqërive që përbëjnë asocimin e përkohshëm;

e) një kopjeje të certifikatës që vërteton se konkurruesi është anëtar i Dhomës së Tregtisë në vendin ku është permanent;

f) në rast të një asocimi të përkohshëm, duhet të paraqitet një kopje e kontratës së asocimit, që tregon shoqërinë që merr përsipër rolin e palës përgjegjëse përkundrejt MIE lidhur me zbatimin e kontratës.

3. Verifikimi i kapacitetit teknik dhe profesional të konkurruesve, nëpërmjet:

a) kopjes së dokumenteve origjinale që vërtetojnë përbërjen ligjore dhe/ose statusin ligjor dhe që përcaktojnë vendin e regjistrimit dhe/ose selinë qendrore ose zyrën e regjistrimit dhe nëse këto të dhëna nuk përputhen, vendndodhjen e selisë qendrore të kompanisë, shoqërisë ose partneritetit, ose të pjesëve të ndryshme që përbëjnë konkurruesit, në rast të një *joint venture* të përkohshme;

b) një raportit që përmban dokumentacionin informativ mbi precedentët e eksperiencës së punës së konkurruesve ose të asocimit të përkohshëm në tendera që kanë pasur natyrë të njëjtë në tre vitet e fundit, dhe lidhur me tenderat e tjera që janë duke u kryer kërkohet gjithashtu informacion specifik rreth efektivitetit dhe pjesëmarrjes konkrete në çdo tender;

c) kualifikimeve dhe eksperiencës së stafit kyç që do të jenë të ngarkuar nga kontraktuesi për zbatimin e kontratës;

d) një raportit të shkurtër mbi aktivitetin e konkurrentëve, të vetëm apo të asociuar, me referim specifik mbi aktivitetet e lidhura me programin.

Krahasimi midis konkurrentëve, mbi bazën e kriterëve të vlerësimit të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, do të kryhet duke përdorur kriteret e përcaktuara dhe duke vlerësuar çmimin për identifikim e konkurrentëve ekonomikisht më të favorizuar.

Kriteret duhet të jenë precize, jodiskriminuese dhe as paragjyquese për një konkurrim korrekt.

Shtojca nr.3

MODALITETI I ZBATIMIT DHE I LIVRIMIT TË KREDISË SË NDIHMËS

SEKSIONI I

NXJERRJA E FISHAVE TË TENDERIT, PROCEDURA APLIKUESE

Dokumentacioni duhet të përgatitet konform shtojcës 2, që përmend Manualin e Procedurave (i përshtatur nga Komisioni European në 10 nëntor 1999), relativ me: Kontratat e shërbimeve, livrimeve dhe punimeve në kuadër të bashkëpunimit komunitar me vendet e treta.

Dokumentacioni në çdo rast duhet:

- të specifikojë “kushtet specifike” përkatëse për çdo tender;
- të sqarojë kriteret e vlerësimit që do të përdorë komisioni i krijuar në MRRT&T.

1- Përgatitja e dokumenteve të tenderit

PIU, me asistencën e ekspertëve të ardhur me mision nga DGCS, do të përgatisë (në rastin e tenderit për shërbimet inxhinierike) ose më saktë do të verifikojë (në rastin e dhënies së tenderit të punimeve, mbas përfundimit të projektimit) dokumentacionin e tenderit për seleksionimin e fituesit.

2- Verifikimi i konformitetit të dokumentacionit të tenderit

Dokumentacioni i tenderit për çdo projekt do të dërgohet-së bashku me kërkesën për publikimin e fishës - nga PIU pranë MAE-DGCS, nëpërmjet Ambasadës Italiane për verifikimin e konformitetit me marrëveshjen prezente. Një verifikim i tillë do të kryhet nga MAE/DGCS, në veçanti, në bazë të përputhjes së:

- dokumenteve ligjore me procedurat e dhëna në shtojcën 2;
- specifikimeve teknike dhe parametrave të vlerësimit me objektivat që programi propozon të arrijë.

3 - Publikimi i fishës

Në rast të një verifikimi pozitiv, fisha do të publikohet nga ana e MAE/DGCS në gazetën italiane, në Buletinin e Kooperacionit dhe në Website të MAE-MRRT&T do të procedojë kontekstualisht për publikimin e fishës në gazetën kombëtare.

SEKSIONI II

FAZA E VLERËSIMIT – PROCEDURA E APLIKUAR

1. Kontrolli i ofertave të dorëzuara për çdo tender do të kryhet nga një komision vlerësimi i krijuar për këtë qëllim nga MRRT&T. PIU do të ndjekë ecurinë e çdo tenderi, duke asistuar edhe komisionin. Në çdo rast, në mbledhjet e komisionit nuk mund të marrë pjesë personeli italian operativ pranë Ambasadës Italiane/UTL ose i dërguar me mision nga DGCS.

2. Për çdo tender, PIU do t'i transmetojë Ambasadës Italiane/UTL dokumentacionin që përmban aktet e komisionit, së bashku me kontratën për vlerësim, duke kërkuar miratimin për hartimin e kontratës. Një dokumentacion i tillë do të jepet nga Ambasada Italiane/UTL tek MAE/DGCS së bashku me komente të mundshme.

3. MAE/DGCS do të verifikojë parimisht përputhjen ligjore dhe teknike të vlerësimeve të kryera me procedurat dhe kriteret/parametrat e parashikuar në përmbledhje të tenderit. Mbasi të jetë kryer verifikimi, MAE/DGCS do të informojë PIU-n, nëpërmjet ambasadës për rezultatin e verifikimit.

4. Në rast të një konkludimi pozitiv (nulla osta) MRRT&T, e asistuar nga PIU, do të procedojë për përgatitjen e kontratës me shoqërinë që do të rezultojë fituese.

SEKSIONI III

FAZA E DHËNIES SË KONTRATAVE DHE LIVRIMEVE TË FONDIT – PROCEDURA E APLIKUAR

1. Kontrata e zyrtarizuar midis kompanive fituese dhe MRRT&T duhet t'i jepet MAE/DGCS nëpërmjet Ambasadës Italiane/UTL, bashkëngjitur kopjes së garancisë së performancës dhe të miratimit të lartpërmendur, me deklaratën e impenjimit të Palës shqiptare për të përballuar kostot lokale (palë përgjegjëse për TVSH-në, taksat doganore, portuale etj.).

2. Mbas marrjes dhe kontrollimit të dokumentacionit, MAE/DGCS do të procedojë duke autorizuar Mediocredito Centrale për të lidhur kontratën mbi Konventën financiare.

3. Mediocredito Centrale do t'u kërkojë firmave italiane të interesuara një “deklaratë angazhimi” që të gjitha mallrat dhe shërbimet janë me origjinë italiane dhe që shpenzimet që mund të bëhen në vend dhe/ose në vendet e treta të industrializuara nuk mund të kalojnë vlerën e përcaktuar në çdo kontratë, si dhe një certifikatë antimafie. Kontekstualisht, Mediocredito Centrale do t'i kërkojë kredimarrësit shqiptar paraqitjen e kërkesës për vënien në dispozicion të fondeve, si dhe shkresën me udhëzimet për bankën agjente.

4. Mbas marrjes së të gjithë dokumentacionit përcaktuar në pikën 3, Mediocredito Centrale do t'i komunikojë kredimarrësit, Bankës Agjente Italiane, si dhe PIU-t, vlefshmërinë e kontratave për konventat financiare, si dhe mënyrën e tyre të financimit. Përfundimi i kësaj procedure do të lejojë livrimin e parapagesës, e parashikuar kjo në kontratat e veçanta, si dhe do të përcaktojë datën e hyrjes në fuqi.

5. Në lidhje me të gjitha pagesat e tjera këto do të vihen në dispozicion vetëm pas miratimit nga ana e PIU-t për zbatimin e shërbimeve të parashikuara në kontratat e veçanta.

LIGJ

Nr.9238, datë 10.6.2004

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË ITALISË PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT “REHABILITIMI DHE PAJISJA E 5 POLIKLINIKAVE””

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë për realizimin e programit “Rehabilitimi dhe pajisja e 5 poliklinikave””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4264, datë 8.7.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS ITALIANE PËR REALIZIMIN E “PROGRAMIT “REHABILITIMI DHE PAJISJA E 5 POLIKLINIKAVE””

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë (MSH) dhe Qeveria e Republikës së Italisë, përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunim dhe Zhvillim (MAE-DGCS), këtu më poshtë të quajtura “Palë Kontraktuese”:

duke u bazuar në protokollin e bashkëpunimit për trevjeçarin 2002-2004, nënshkruar në datën 9 prill 2002, ku kooperacioni italian ka konfirmuar impenjimin financiar për rikonstruksionin e 5 poliklinikave të vendosura në Tiranë (2), Gjirokastrë, Peshkopi dhe Korçë, duke destinuar për këtë qëllim një kredi në formë ndihme prej 5 000 000 euro;

Që në vazhdim të sondazhit projektues të bërë nga zyrat kompetente të DGCS-së, Komiteti Drejtues i MAE/DGCS-së ka aprovuar në mbledhjen e datës 29.7.2003 iniciativën: "Rehabilitimi dhe pajisja e 5 poliklinikave", që këtu më poshtë do të quhet "Programi", duke akorduar për këtë qëllim një kredi të butë prej 5 080 000 eurosh dhe një grant (ndihmë) prej 110 000 euro, për të bërë të mundur të gjitha aktivitetet e projektimit, realizimit dhe monitorimit;

Bazuar sa më sipër, Palët Kontraktuese kanë vendosur sa më poshtë:

Neni 1

Qëllimi dhe pjesët e Marrëveshjes

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është të rregullojë impenjimet reciproke të të dyja palëve për zbatimin korrekt të programit dhe në mënyrë të veçantë i referohet mënyrës së vlerësimit të kontratave, si dhe menaxhimit/ndërprerjes/dhënies së fondeve të kredisë së butë.

Kjo Marrëveshje është e përbërë nga 14 nene dhe nga 3 shtojcat e mëposhtme, që janë pjesë integrale e saj:

1. Përmbledhje e programit.
2. Prokurimi i shërbimeve, pajisjeve dhe punimeve (kushtet e veçanta).
3. Mënyra e ekzekutimit dhe menaxhimi i kredisë së butë.

Neni 2

Objektivat e programit

Objektivi i përgjithshëm i programit është që të kontribuojë në përmirësimin e kushteve të shëndetit të popullsisë përfutuese dhe në të njëjtën kohë të përmirësojë kostot e menaxhimit të sistemit shëndetësor.

Objektivi specifik ka qëllim të përmirësojë dhënien e shërbimit shëndetësor në 5 poliklinikat, referuar kualitetit dhe mbulimit të zonës ku do të jepet ky shërbim.

Neni 3

Përshkrimi i programit

Programi është përshkruar në mënyrë të shkurtuar në shtojcën 1 dhe ka qëllim të arrijë rezultatet e mëposhtme:

- 5 poliklinika të rehabilituara dhe të pajisura;
- shtimin e dhënies së shërbimit me të paktën 50 %;
- aktivitete të shëndetit preventiv të përmirësuara dhe uljen e patologjive në sektorin e sëmundjeve të transmetueshme, shëndetin riprodhues dhe pediatri.

Implementimi i programit do të bëhet nëpërmjet aktiviteteve të mëposhtme:

- faza projektuese;
- punimet e rehabilitimit fizik dhe impiantet;
- furnizimi i pajisjeve mjekësore, materialet e konsumit dhe trajnimi për përdorimin e mirë dhe mirëmbajtjen.

Neni 4

Institucionet e përfshira në realizimin e programit

Institucionet e përfshira në realizimin e programit janë si më poshtë:

Për Palën Shqiptare:

a) MSH-ja do të sigurojë zbatimin e detyrimeve që dalin nga kjo Marrëveshje, duke përfshirë strukturat e tjera shqiptare kompetente.

b) Ministria e Financave (MF) që do të nënshkruajë Marrëveshjen financiare me MCC-në dhe që do të kujdeset për kontaktet operative me këtë të fundit dhe me bankat agjente, sipas asaj që do të jetë përcaktuar në Marrëveshjen financiare.

c) PIU i ngritur pranë MSH-së do të kujdeset për koordinimin e funksioneve të natyrës teknike dhe menaxhuese të nevojshme për realizimin e programit.

Për Palën Italiane:

a) MAE/DGCS-ja që do të sigurojë lëshimin e fondeve dhe burimeve financiare të kredisë, sipas mënyrave të parashikuara nga normativat italiane në fuqi, që në mënyrë sintetike janë paraqitur në këtë Marrëveshje. MAE/DGCS-ja, në bashkëpunim me MSH-në, do të ketë si detyrë monitorimin e ecurisë së programit, si dhe të ndjekë ecurinë e rezultateve të përcaktuara në nenin 3. MAE/DGCS-ja do të veprojë nëpërmjet zyrave kompetente për kryerjen e detyrave të saj. Në mënyrë të veçantë Zyra Teknike Qendrore e MAE/DGCS-së, këtu më poshtë e quajtur UTC do të sigurojë të gjitha funksionet e natyrës teknike në mbështetje të realizimit të programit.

b) Mediocredito Centrale (MCC), që sipas udhëzimeve të MAE/DGCS-së dhe të Ministrisë së Ekonomisë Italiane do të nënshkruajnë me Ministrinë e Financave Shqiptare një marrëveshje financiare që do të rregullojë përdorimin e fondeve të kredisë së butë. Në kuadër të kësaj Marrëveshjeje financiare, MCC-ja do të kujdeset për rregullsinë e secilës kontratë për dhënien e të mirave materiale, shërbimeve dhe punimeve nëpërmjet të cilave do të realizohen aktivitetet e parashikuara në program. Do të jetë gjithashtu nën kujdesin e MCC-së të sigurojë pagesën e shumave korresponduese kontraktuale të organizmave realizues.

c) Ambasada/UTL (Zyra Teknike Lokale) e Tiranës do të sigurojë të gjitha funksionet e natyrës teknike të nevojshme për supervizionin korrekt të ecurisë së aktiviteteve. Në kuadër të aktiviteteve të saj institucionale, Ambasada/UTL do të sigurojë gjithashtu kontaktet e nevojshme me palën homologe në program, duke u kujdesur nëpërmjet të tjerave për marrjen dhe dërgimin e të gjithë dokumentacionit zyrtar.

Neni 5

Burimet financiare e mënyra e përdorimit të kredisë së butë

Burimet financiare të nevojshme për realizimin e programit janë si më poshtë:

1. Kredia e butë prej 5 080 000 euro për realizimin e të gjitha aktiviteteve të parashikuara në program (projekte, punime, pajisje dhe asistencë teknike/trajnim).

2. Grant 110 000 euro si fond për ekspertët e DGCS-së për aktivitete të asistencës për Ambasadën/UTL dhe për monitorimin periodik të ndërhyrjes.

3. Fondi i Qeverisë shqiptare rreth 500 000 euro për kosto lokale (TVSH, taksa doganore etj.).

Termat dhe kushtet e kredisë së butë janë si më poshtë:

- Periudha e rimbursimit të kredisë	38 vjet
- Periudha e garancisë (për rimbursimin e kredisë)	17 vjet
- Taksa e interesit vjetor	0,10%

Mbi bazën e procedurave në fuqi pranë MAE/DGCS-së, hapat kryesore që duhen ndjekur për përdorimin e fondeve të kredisë së butë janë si më poshtë (më mirë të shpjeguara në shtojcën 3):

1. Nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje.

2. Lëshimi nga ana e Ministrisë së Ekonomisë Italiane i një dekreti ministror që autorizon MCC-në të negociojë dhe të nënshkruajë Marrëveshjen financiare me Ministrinë e Financave.

3. Nënshkrimi i Marrëveshjes financiare midis MCC-së dhe MF-së.

4. Përgatitja e listës së dokumentacionit të garës së prokurimit si më poshtë, e nevojshme kjo e fundit për ekzekutimin e aktiviteteve të parashikuara nga programi:

- për projektimin e punimeve të rehabilitimit civil dhe të impianteve;
- për ekzekutimin e këtyre punimeve;
- për furnizimin e pajisjeve mjekësore.

5. Zhvillimin e këtyre garave të prokurimeve dhe ekzaminimin e ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të ngritur nga MSH-ja për zgjedhjen e fituesit.

6. Verifikimin e rregullsisë së procedurave të garave të prokurimit të zhvilluara nga ana MAE/DGCS-së dhe të kontratave që do të lidhen dhe në raste përgjigjesh pozitive lidhjen e kontratave nga ana e MSH-së.

7. Rregullsinë dhe kalimin e kontratave të lidhura, sipas garave, mbi Marrëveshjen financiare me mënyrat e dhënies së fondeve të treguara në shtojcën nr.3.

Neni 6

Monitorimi i programit

Ecuria e programit do të monitorohet në mënyrë të përbashkët nga MAE/DGCS-ja (nëpërmjet misionëve periodike të funksionarëve dhe ekspertëve për këtë qëllim të caktuar) dhe nga MSH-ja. Palët Kontraktuese impenjohen që tani për të përcaktuar të gjitha masat që do të shohin të nevojshme të marrin, në qoftë se gjatë zhvillimit të programit skema e indikatorëve nuk do të respektohet ose, më mirë, nuk do të jetë e përshtatshme në lidhje me kushtet sektoriale lokale.

Neni 7

Mënyra e blerjes së shërbimeve, pajisjeve dhe punimeve

Përcaktimi i ekzekutuesve të aktiviteteve të programit do të bëhet nëpërmjet zhvillimit të garave të disiplinuar nga dispozitat që përmban Manuali i Procedurave (i përdorur nga Komisioni European i 23 dhjetorit 2002) që lidhet me: "Prokurimin e shërbimeve, pajisjeve dhe punimeve në kuadër të kooperacionit komunitar me vendet e treta", si dhe me sa është sqaruar me shtojcën 2.

Neni 8

Detyrimet e Qeverisë shqiptare

Qeveria shqiptare impenjohet:

- të vërë në dispozicion burimet financiare që i takojnë me vlerë ekuivalente 500 000 euro;
- të bëjë operative të gjitha veprimet, aktivitetet dhe aktet formale të nevojshme për ecurinë e mirë të programit;
- të bashkëpunojë me MAE/DGCS-në për aktivitetet e monitorimit të programit referuar nenit 6 edhe për t'i dhënë akses në dokumentacionin ekzistent dhe në zonat e aktiviteteve.

Neni 9

Detyrimet e Qeverisë italiane

Qeveria italiane impenjohet të garantojë financimet e mëposhtme:

- deri në 5 080 000 euro si kredi e butë, që do të bëhet e disponueshme pranë MCC-së dhe do të disbursohet sipas mënyrave të përcaktuara në shtojcën 3;
- deri në 110 000 euro si dhuratë (grant), që do të menaxhohet direkt nga MAE/DGCS-ja për të asistuar Ambasadën /UTL dhe për aktivitetet e monitorimit.

Neni 10

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që do të lindë midis Palëve në marrëveshje, në lidhje me interpretimin dhe aplikimin e kësaj Marrëveshjeje, do të zgjidhet, për sa është e mundur, nëpërmjet konsultimeve dhe bisedimeve.

Neni 11

Pengesat dhe forcat madhore

Në raste pengesash për realizimin e programit, të ardhura për shkak të forcave madhore (lufta, përmbytje, zjarre, tufane, tërmete, konflikte pune, greva, vendime të secilës qeveri, pengesa të paparashikuara në transporte dhe shkaqe të tjera) të njohura nga të dyja Palët ose raste rreziqesh dhe kushte me risk për personelin e huaj do të adoptohen dispozitat e mëposhtme, të bazuara në rekomandimet e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe të aprovuara nga MAE/DGCS-ja:

a) Në qoftë se zgjatja e pengesave për realizimin e programit është më e vogël se 6 muaj, përdorimi i fondeve të paimpenjuara do të bllokohet deri sa MAE/DGCS-ja do të autorizojë rihapjen e aktiviteteve.

b) Në qoftë se zgjatja e pengesave është më e madhe se 6 muaj dhe më e vogël se njëzet e katër, programi ndërpritet dhe fondet e paimpenjuara mbahen deri sa të eliminohet pengesa dhe të vijë autorizimi i MAE-DGCS-së për rifillimin e aktiviteteve.

c) Në qoftë se zgjatja e pengesave do të jetë me e madhe se njëzet e katër muaj, Palët janë të detyruara të bien dakord mbi vazhdimin e programit dhe të caktojnë radhën e veprimeve. Në rast pamundësie për të vazhduar aktivitetet, Palët duhet të vendosin mbi destinacionin e fondeve të paimpenjuara.

Neni 12

E drejta për të zgjidhur Marrëveshjen nga MAE-DGCS-ja

MAE-DGCS-ja rezervon të drejtën për t'u tërhequr nga Marrëveshja në rastet e mëposhtme:

a) Mosrealizimi i aktiviteteve të programit, për shkaqet që nuk mund t'i ngarkohen Palës Italiane.

b) Zgjatje e pengesave ose forcave madhore në bazë të nenit 11.

Në të dyja rastet e përmendura më sipër, MAE-DGCS-ja mund të vendoset në mënyrë të njëanëshme përfundimin e Marrëveshjes, duke njoftuar MSH-në nëpërmjet një note verbale me të paktën tre muaj paralajmërim. Në çdo rast, pas këtij njoftimi, MSH-ja është e detyruar të ndërpresë aktivitetet e programit, përveç ndonjë marrëveshje tjetër midis Palëve.

Neni 13

Ndryshimet

Palët në Marrëveshje, në çdo moment, mund të propozojnë modifikime për përmbajtjen e Marrëveshjes, nëpërmjet shkëmbimit të notave dhe rrugëve diplomatike. Modifikimet e aprovuara do të hyjnë në fuqi me të njëjtën procedurë të parashikuar nga Marrëveshja për hyrjen e saj fuqi.

Neni 14

Hyrja në fuqi, zgjatja dhe denoncimi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të dytë, me të cilën Palët në Marrëveshje do të komunikojnë zyrtarisht kryerjen e procedurave respektive të brendshme, për këtë qëllim të parashikuar.

Kjo Marrëveshje do të jetë trevjeçare dhe e rinovueshme automatikisht për periudha me kohëzgjatje të njëjtë.

Kjo Marrëveshje mund të denoncohet në çdo moment dhe denoncimi do të ketë efekt gjashtë muaj pas njoftimit të palës tjetër në Marrëveshje.

Duke besuar se përfaqësuesit për nënshkrim, të autorizuar për këtë nga qeveritë përkatëse, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në Tiranë më 17 mars 2004, në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe italiane.

Në rast mosmarrëveshjes në interpretim, do merret për bazë teksti në gjuhën italiane.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

LEONARD SOLIS

PËR QEVERINË E
REPUBLIKËS SË ITALISË

ATTILIO MASSIMO IANNUCCI

PËRMBLEDHJA E PROGRAMIT

Objektivi

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është i dyfishtë; nga njëra anë kontribuohet për përmirësimin e kushteve të shëndetit të popullsisë përfutuese dhe nga ana tjetër tenton të optimizojë kostot e menaxhimit të sistemit.

Si objektiv specifik mendohet të sigurohet një përmirësim i dhënies së shërbimeve shëndetësore të specializuar, duke iu referuar sasisë dhe shtrirjes për të mbuluar një sipërfaqe sa më të madhe të popullsisë në 5 poliklinika, nga të cilat Tirana 2, Tirana 3, poliklinikat e Gjirokastrës, Korçës dhe Peshkopisë, si dhe rritjen e kapaciteteve menaxhuese të drejtuesve shëndetësorë të këtyre rrethve.

Rezultatet e pritshme të këtij programi janë:

- 5 poliklinika të rehabilituara dhe të pajisura.
- Rritja e dhënies së shërbimeve më shumë se 50%.
- Përmirësimi i aktiviteteve mjekësore të parandalimit me ulje të patologjive në fushën e sëmundjeve të transmetueshme, shëndetit riprodhues dhe pediatrikë.

Aktivitetet e parashikuara

Për arritjen e këtyre rezultateve, kjo iniciativë parashikon: (i) fazën e projektimit; (ii) punimet e rehabilitimit të godinave dhe impianteve; (iii) pajisjen e tyre me aparaturë biomedikale diagnostikuese dhe materiale konsumi, formimin e personelit për mirëpërdorimin e tyre dhe mirëmbajtjen.

Për secilën nga këto 5 poliklinika do të ndërhyhet me punime rehabilitimi fizik dhe në implant në funksion të nevojave të ndryshme që do të ndeshen; bëhet fjalë për ndërhyrje në strukturë, si suvatime dhe veshje muresh të përshtashme për ambiente ambulatorë, për ribërjen e impianteve sanitare dhe elektrike. Këto ndërhyrje kanë qëllim të bëjnë ambiente ambulatorë, funksionale dhe higjenikisht të përshtashme, në përputhje të plotë me normat e sigurisë për punonjësit e strukturës dhe pacientët.

Në fazën e formulimit është ndjekur një analizë e thelluar për aparaturat e nevojshme dhe funksionale, sipas rolit që ka secila poliklinikë.

Kujdes i veçantë është treguar për të pasur një standard homogjen të aparaturave, duke privilegjuar kualitetin e shërbimit dhe ndërhyrjen e mirëmbajtjes së mundshme në Shqipëri.

Gjithashtu, është parashikuar një kuotë paraprake për materiale konsumi, e llogaritur në 10% të kostos globale të aparaturave.

Kostoja e aparaturave me teknologji më të përparuar se ato që ndodhen prezent aktualisht, është përlllogaritur duke marrë parasysh një paketë trajnimit dhe pjesë këmbimi të firmave furnizuese (në fazën e formulimit të kapitullarit, midis kritereve të përzgjedhjes së firmës fituese, do të jepet një pikavarazh specifik për këtë aspekt të trajnimit).

Shpenzimet e përafërta të projektit janë detajuar si më poshtë (të mbuluara nga kredia me terma.

Poliklinika	Rehabilitime (euro)	Pajisje (euro)	Totali (euro)
Gjirokastra	142 400	280 500	422 900
Korça	597 000	651 500	1 248 500
Peshkopia	179 500	460 000	639 500
Tirana 2	446 500	678 000	1 124 500
Tirana 3	666 000	686 000	1 352 000
Nr. totali	2 031 400	2 756 000	4 787 400
Të ndryshme (5%)	101 570	0	0
Totali i pjesshëm	2 132 970	2 756 000	4 888 970
Projektimi	106 649	82 680	189 329
Totali	2 239 619	2 838 680	5 078 299
Totali përfundimtar	2 240 000	2 840 000	5 080 000

TENDERIMI I SHËRBIMEVE, PAJISJEVE DHE PUNIMEVE (KUSHTET E VEÇANTA)

Kjo shtojcë i referohet përdorimit të kredisë së butë italiane.

Zgjedhja e firmave do të bëhet nëpërmjet garave të prokurimit të hapura, të rezervuara për shoqërinë italiane. Përqindja e kredisë së butë e harxhuar në vend, në vendet në zhvillim, nuk mund të kalojë 45% të vlerës së vetë kredisë.

Për përcaktimin e të gjitha garave të parashikuara në program, do të adoptohen procedurat e parashikuara në Manualin e Procedurave (të adoptuara nga Komisioni European i 23 dhjetorit 2002) për garat e shërbimeve, furnizimin dhe punimet në kuadër të kooperacionit, komunitetit me vendet e treta.

Në çdo rast, procedura e seleksionimit duhet të përfshijë:

1. Verifikimin e besueshmërisë së ofertës (persona juridikë, shoqëri ose ndërmarrje), që nuk do të quhen të besueshme në qoftë se:

a) janë në procedura falimentimi, likuidimi, administrimi të kontrolluara ose të konkorduar paraprakisht, të mbylljes së aktivitetit ose që janë objekt i një procedure të ngjashme të parashikuara nga ligjet dhe rregullat kombëtare;

b) janë objekt i një procedure të deklarimit të falimentimit, të likuidimit, të administrimit të kontrolluar, të një marrëveshjeje paraprake ose të një procedure të ngjashme të parashikuar nga ligjet dhe rregullat kombëtare;

c) kanë marrë një dënim të parikuperueshëm për një krim në lidhje me moralitetin profesional;

d) janë përgjegjëse për shkelje të rënda të detyrimeve profesionale, të provuara me çdo lloj elementi të dokumentuar nga administrata aprovuese e garave;

e) nuk janë në rregull me obligimet për kontributet sociale, sipas dispozitave legjislative të vendit në të cilin janë vendosur;

f) nuk janë në rregull me obligimet për taksat dhe detyrimet financiare sipas dispozitave legjislative të vendit në të cilin janë vendosur;

g) janë fajtorë për pasaktësi të rënda në dhënien e informacionit të kërkuar nga administrata aprovuese e garave në lidhje sa më sipër;

h) janë deklaruar fajtorë, për shkakun se nuk kanë respektuar detyrimet kontratuale, mungesa të rënda në ekzekutimin e punimeve, në kuadër të një kontrate të nënshkruar nga e njëjta administratë aprovuese e garave ose në kuadër të një kontrate të financuar nëpërmjet fondeve të Komunitetit European. Si shtesë, ofruesit italianë janë të detyruar të paraqesin një certifikatë ose deklaratë ekuivalente për mosqenien në kategoritë e përcaktuara nga dekreti legjislativ italian i 8 gushtit 1994, nr.490 (*"antimafia"*).

Vepruesit duhet gjithashtu të paraqesin, në mbështetje të ofertave tyre, provat e duhura, konform legjislacionit të vendit në të cilin janë vendosur, që të tregojnë se ata nuk ndodhen në asnjë prej situatave të parashikuara në pikat a, b, c dhe f.

2. Verifikimi i gjendjes ekonomike dhe financiare të ofruesve, nëpërmjet:

a) Deklarimit të kapitalit social të shoqërisë dhe të faturimit në tre vjetët përpara garës.

b) Deklarimin e faturimit total të konkurrentëve dhe, në raste të shoqërive të përkohshme, faturimin e secilit prej pjesëmarrësve.

c) Deklarimin e faturimit në sektorë specifikë të cilëve iu referohet gara ose të sektorit në të cilin, në rastin e shoqërive të përkohshme, shoqëria në mënyrë individuale mendon të kontribuojë.

d) Deklaratë e përshtatshme e përfaqësuesve ligjorë ose një certifikatë bankare, që të përmbajë informacion mbi relacionet me institutet bankare me peshë ndërkombëtare që të demonstrojnë besueshmërinë financiare dhe komerciale të konkurrenësve dhe të shoqërive që përbëjnë shoqërinë e përkohshme.

e) Një kopje të certifikatës që tregon se konkurrenti është anëtar i dhomës së tregtisë në vendin në të cilin është vendosur.

f) Në rastin e shoqërive të përkohshme, duhet të paraqitet një kopje e kontratës së bashkimit ku të tregohet secila shoqëri do të marrë rolin përgjegjës të përfaqësimit të qëndrueshëm përpara MIE-së në rastin e ekzekutimit të mundshëm të kontratës.

3. Verifikimi i kapacitetit teknik dhe profesional të konkurrentëve nëpërmjet:

a) Kopje të dokumentacionit origjinal që të tregojë ndërtimin ligjor e/ose statutin juridik që përcakton vendin e regjistrimit e/ose zyrën qendrore ose zyrën e regjistrimit dhe, në qoftë se këto nuk përputhen, vendin e zyrës kryesore të shoqërisë ose të bashkëpunimit të zakonshëm, ose të pjesëve të ndryshme të konkurruesve, në rastin e shoqërive të përkohshme.

b) Një raport që të përmbajë dokumente dhe informacione mbi eksperiencat e punës së mëparshme të konkurrentëve dhe në rast shoqërish përkohshme në garat me të njëjtën natyrë në tre vjetët e mëparshëm, dhe gara të tjera në vazhdim me informacione specifike rreth efektivitetit dhe pjesëmarrjes konkrete në çdo garë.

c) Kualifikimet dhe eksperiencën e personave kyç të stafit që do të ngarkohen nga kontraktuesi për ekzekutimin e kontratës.

d) Një raport mbi aktivitetin e konkurruesve, të veçantë ose të bashkuar, vetëm për aktivitetet e lidhura me programin.

Krahasimi ndërmjet konkurruesve, mbi bazën e kriterëve të besueshmërisë së përcaktuar në shpalljen e garës është në dosjen e garës, do të bëhet duke përdorur kriteret e përcaktuara dhe çmimin për identifikimin e konkurrentit ekonomikisht më të përshtatshëm. Kriteret duhet të jenë precize, jo diskriminuese, as paragjyqese për një konkurrim korrekt.

Shtojca 3

MËNYRA E EKZEKUTIMIT DHE E MENAXHIMIT TË KREDISË SË BUTË

SEKSIONI 1

SHPALLJA E GARAVE, PROCEDURAT E APLIKUARA

Dokumentacioni i garave duhet të jetë ndërtuar konform shtojcës 2, që i referohet Manualit të Procedurave (të adoptuara nga Komisioni European në 23 dhjetor 2002) për garat e shërbimeve, furnizimin dhe punimet në kuadër të kooperacionit të Komunitetit me vendet e treta. Dokumentacioni duhet, në çdo rast:

- të specifikojë “kushtet speciale” për secilën garë;
- të përcaktojë kriteret e vlerësimit që do të përdoren nga komisioni i ndërtuar nga MSH-ja.

1. Përgatitja e dokumentacionit të tenderit

Dokumentacioni i garës për dhënien e shërbimeve të projektimit të punimeve të ristrukturimit fizik dhe impianteve, si dhe specifikimet për pajisjet mjekësore të duhura, do të predispozohen nga Ambasada/UTL (duke përdorur pjesë të financimit grant) dhe do t'i transmetohet PIU-t pranë MSH-së për verifikimet e kompetencës së Palës Shqiptare. Ky dokumentacion garë, i verifikuar ose i integruar nga MSH-ja, do të dërgohet nga PIU pranë Ambasadës/ UTL së bashku me kërkesën për publikimin e lajmërimit të garës në gazetën italiane.

Dokumentacioni i garave për ekzekutimin e punimeve dhe ajo për furnizimin me pajisje mjekësore do të përgatiten nga shoqëria italiane që do të dalë fituese e garës së parë dhe do të verifikohen nga MSH-ja, që do të kujdeset t'ia përciellë Ambasadës/UTL, së bashku me kërkesën për publikimin e lajmërimit të garës në gazetën italiane.

2. Verifikimi i konformitetit të dokumentacionit të garës

Verifikimi i konformitetit me këtë Marrëveshje do të bëhet nga MAE/DGCS-ja dhe do të jetë, në mënyrë të veçantë, mbi këto kriterë:

- Përmbajta me karakter ligjor me procedura të shtojcës 2;
- Specifikimet teknike të parametrave të vlerësimit me objektivat që programi propozon të arrijë;

- Publikimi i lajmërimit.

Në rastin e aprovimit, lajmërimet e garave do të bëhen rast pas rasti nga MAE/DGCS-ja, në gazetatat italiane, në Buletinin e Kooperacionit dhe në faqen WEB të MAE-së, MSH-së do të vazhdojë në të njëjtën mënyrë të publikojë lajmërimin në gazetatat kombëtare.

SEKSIONI 2

FAZA E VLERËSIMIT-PROCEDURA E APLIKUAR

1. Ekzaminimi i ofertave të ardhura do të bëhet nga një komision vlerësimi i ngritur për këtë qëllim nga MSH-ja. PIU-n pranë MSH-së do të ndjekë ecurinë e garave, duke asistuar aty ku është i nevojshëm komisioni. Në çdo rast, në mbledhjet e komisionit nuk mund të marrë pjesë personel italian që punon pranë Ambasadës/UTL se më mirë i dërguar në mision nga DGCS-ja.

2. PIU do t'i dërgojë Ambasadës/UTL dokumentacionin që përmban aktet e komisionit, vetëm për kontratat që do të lidhen, duke kërkuar aprovimin për firmosjen e tyre. Ky dokumentacion do të dërgohet nga Ambasada/UTL pranë MAE/DGCD-së me komentet e mundshme.

3. MAE/DGCS-ja do të verifikojë kryesisht përputhjen ligjore dhe teknike të vlerësimit të kryer me procedurën dhe kriteret/parametrat e parashikuara në secilin dokumentacion garë. Pas kompletimit të verifikimit, MAE/DGCS-ja do të informojë PIU-n, nëpërmjet Ambasadës/UTL, për përgjigjen e tij.

4. Në rast përgjigje pozitive (*aprovim*), MSH-ja do të procedojë me firmosjen e kontratës me shoqërinë që do të jetë fituese.

SEKSIONI 3

FAZA E KALIMIT TË KONTRATAVE DHE E LËSHIMIT TË FONDEVE-PROCEDURAT E APLIKUARA

1. Kontrata rast pas rasti të nënshkruara midis shoqërive italiane dhe MSH-së duhet të dërgohen te MAE/DGCS-ja nëpërmjet Ambasadës/UTL, bashkëlidhur me kopjen *performancë bond*, me deklarin e impenjimit të Palës Shqiptare për të përballuar kostot lokale (TVSH, taksa doganale, shpronësime, etj).

2. Pas marrjes dhe ekzaminimit të këtij dokumentacioni, MAE/DGCS-ja do të kujdeset që të autorizojë Mediocredito Centrale të kalojë çdo kontratë të veçantë në Konventën financiare.

3. Mediocredito Centrale do të kërkojë nga shoqëria italiane e interesuar një "*dekleratë impenjimi*" që materialet dhe shërbimet të jenë me origjinë italiane dhe që shpenzimet që do të përballohen në vend ose në vende të treta nuk mund të kalojnë 45% të vlerës së kontratës, si dhe një certifikatë antimafia. Në të njëjtën mënyrë, Mediocredito Centrale do t'i kërkojë kredituesit shqiptar dërgimin e kërkesës për vënien në dispozicion të fondeve dhe letrën për bankën agjente.

Pas marrjes në dispozicion të të gjithë dokumentacionit sipas pikës 3, Mediocredito Centrale do t'i komunikojë kredituesit, bankës agjente italiane dhe PIU-t pranë MSH-së, kalimin e kontratës në Konventën financiare dhe financueshmërinë e saj.

Kompletimi i kësaj procedure do të lejojë lëshimin e paradhënies së pagesës, aty ku kjo është parashikuar nga kontratat dhe do të përcaktojë datën efektive të hyrjes në fuqi të vetë kontratës.

Përsa i përket të gjitha pagesave të tjera, ato mund të bëhen vetëm pas aprovimit për kryerjen e plotë të punimeve/shërbimeve nga ana e MSH-së, sipas asaj që është përcaktuar në kontratë.

LIGJ
Nr.9241, datë 10.6.2004

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8677, DATË 2.11.2000 “PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E POLICISË GJYQËSORE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8677, datë 2.11.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Pas nenit 12 shtohet neni 12/a me këtë përmbajtje:

“Neni 12/a
Pagat e oficerëve të seksioneve të policisë gjyqësore

1. Paga e oficerit të policisë gjyqësore – jurist, të seksioneve të prokurorive të rretheve gjyqësore dhe të prokurorive të apelit është e barabartë me 70 për qind të pagës së prokurorit të prokurorisë së rrethit gjyqësor.

2. Paga e oficerit të policisë gjyqësore – jurist, të seksionit të Prokurorisë për Krime të Rënda dhe të Prokurorisë së Apelit për Krime të Rënda, si dhe të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm është 20 për qind më e lartë se ajo e parashikuar për oficerin e policisë gjyqësore – jurist në pikën 1.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe efektet financiare të tij fillojnë në datën 1 korrik 2004.

Shpallur me dekretin nr.4267, datë 8.7.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr.4252, datë 1.7.2004

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të neneve 15,19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|---------------------------------------|--|
| 1. Oltjon Agron Sulanjaku | 31. Muhamed Ilir Kaso |
| 2. Mikel Agron Sulanjaku | 32. Mirjana Isuf Izadi (Krasniqi) |
| 3. Valbona Kastriot Xhufi | 33. Altina Dhimitri Plasoti (Petro) |
| 4. Fatbardha Trifon Aziri (Kondakciu) | 34. Petrit Nedin Gjoni |
| 5. Astrit Veli Koroveshi | 35. Alfred Simon Konini |
| 6. Rozana Idris Nemeth (Molla) | 36. Albana Alfred Konini |
| 7. Albana Kasem Vrioni (Dine) | 37. Julia Alfred Konini |
| 8. Marcel Dritan Vrioni | 38. Alma Albert Konini (Asllani) |
| 9. Lumturie Avdyl Fleitmann (Lala) | 39. Eris Eduart Xhaferaj |
| 10. Iriselda Myzafer Fleitmann | 40. Robert Seit Kosova |
| 11. Ermira Nexhat Schmidt (Dishnica) | 41. Eno Ylli Serjani |
| 12. Dritan Et'hem Reipa (Mullajonuzi) | 42. Adriana Fuat Emmanouilidou |
| | (Vojkollari) |
| 13. Arben Xhemal Blume (Shatrolli) | 43. Ilir Zubihi Dalani |
| 14. Astrit Hasan Dumi | 44. Alketa Kurtel Böhme (Cino) |
| 15. Arben Eqrem Abazi | 45. Trëndafile Fezulla Neuhaus |
| | (Sulollari) |
| 16. Gani Hamid Blakçori | 46. Fatbardha Engjëll Schläger (Sofka) |
| 17. Astrit Ahmet Selimaj | 47. Suela Sabri Martsch (Hoxholli) |
| 18. Gjiliola Skënder Kokoli (Dhora) | 48. Johannes Harald Hoxholli |
| 19. Albano Adrian Kokoli | 49. Nasuf Ismail Mecka |
| 20. Ina Adrian Kokoli | 50. Ismail Nasuf Schirrmann |
| 21. Cindy Adrian Kokoli | 51. Leonard Nasuf Schirrmann |
| 22. Suela Rexhep Reçi | 52. Zamir Ruzhdi Peshkopia |
| 23. Jola Shpendi Sejdarasi | 53. Luan Ylli Bytyçi |
| 24. Aisel Fatmir Spartaku | 54. Skënder Beq Kasemi |
| 25. Ali Shaban Remilli | 55. Bejaze Selim Sulova |
| 26. Anton Zef Bregu | 56. Najada Halil Myrto |
| 27. Elma Hysen Miloti | 57. Saimir Vasil Murja |
| 28. Elton Ramazan Aliaj | 58. Ruzhdi Servet Tuçi |
| 29. Nora Anton Malice (Meshi) | 59. Erhard Luftar Tragaj |
| 30. Manjola Mentor Kaso (Doçe) | 60. Ervin Nikollaq Prenda (Tramonte) |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

VENDIM
Nr.281, datë 16.4.2004

PËR NGRITJEN E BORDIT TË KULLIMIT NË ZONËN E SHËRBIMIT TË KULLIMIT TË KORÇËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 35 e 41 të ligjit nr.8518, datë 30.7.1999 “Për ujitjen dhe kullimin”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Korçës, i cili financohet nga Buxheti i Shtetit.

2. Zona e shërbimit të kullimit të këtij bordi përbëhet nga:

a) zona e fushës Korçë-Dvoran-Qafë Qarr (KOK1/1), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 5400 ha;

b) zona e fushës Diga Zemblak-Maliq (KOK1/2), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 9330 ha;

c) zona e fushës Pirg-qyteti Maliq (KOK1/3), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 2870 ha;

ç) zona e fushës së Maliqit (KOK-2) me sipërfaqe 5300 ha;

d) zona e fushës Makers-Lubonjë (KOK-3, KOK-4), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 282 ha;

dh) zona e fushës Liqenas-Goricë (KOK-5, KOK-6), me sipërfaqe 333 ha;

e) zona e fushës Cangonj-Progër-Vranisht-Tren (DVK-1) me sipërfaqe 2339 ha;

ë) zona e fushës Hoçisht-Vërlen-Vishocicë (DVK-2, DVK-3), me sipërfaqe 993 ha;

f) zona e fushës Qendër-Qytet (ERQ), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 360 ha;

g) zona e fushës Makërz-Çlirim-Boshanj-Vodicë (ERC-1, ERM-1,2), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 101 ha;

gj) zona e fushës Kagjinë-Barmash-Sudenicë-Leskovik-Ymelinë-Radanjë (ERP-1,2, ERL-1,2) që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 270 ha;

h) pendët mbrojtëse nga përmytjet e lumenjve dhe të kanaleve të ujërave të larta;

i) sistemi i mbrojtjes nga gërryerja e lumenjve dhe të përrenjve.

3. Këshilli i përfaqësuesve të bordit të përbëhet nga:

a) 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit;

b) 3 (tre) përfaqësues nga federatat dhe shoqatat e përdoruesve të ujit, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

c) 3 (tre) përfaqësues të komunave, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

ç) 2 (dy) përfaqësues të bashkive, brenda zonës së shërbimit të kullimit

d) 1 (një) përfaqësues i këshillit të qarkut;

dh) 1 (një) përfaqësues i biznesit, me veprimtari brenda zonës së shërbimit të kullimit.

4. Anëtarët e këshillit të përfaqësuesve të shpërblehen, çdo muaj me 5000 (pesë mijë) lekë.

5. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, i miratuar për Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit.

6. Ngarkohet Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.429, datë 2.7.2004

PËR KALIMIN E PORTIT TË PESHKIMIT, SHËNGJIN NË ADMINISTRIM TË NDËRMARRJES SË RRITJES SË MIDHJEVE SARANDË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Ministrisë të Bujqësisë dhe të Ushqimit, të Ministrisë të Transportit dhe të Telekomunikacionit dhe të Ministrisë të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Porti i peshkimit, Shëngjin, së bashku me infrastrukturën përkatëse, sipas genplanit që i bashkëlidhet këtij vendimi, t'i kalojë në administrim ndërmarrjes së rritjes së midhjes, Sarandë.


2. Për ndërmarrjen e rritjes së midhjeve, Sarandë të ruhet pronësia shtetërore, në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit.

3. Ngarkohen Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit, Ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit dhe Ministri i Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano



VENDIM
Nr.430, datë 2.7.2004

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.392, DATË 15.8.2002 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
RROGOZHINË-ELBASAN, NË QARKUN E ELBASANIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit

nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik” dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.392, datë 15.8.2002 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 3 të shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3/1. Pronari i pasurisë së paluajtshme shtesë “Alba Posta”, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, e cila paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqe ndërtimore 90 m², sipas certifikatës së pronësisë me nr.730, datë 21.11.2001, me çmimin e dhënë nga Enti Kombëtar i Banesave prej 23 962 lekë/m², vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 2 156 580 (dy milionë e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë) lekësh.”.

2. Pas pikës 5 të shtohet pika 5/1 me këtë përmbajtje:

“5/1. Fondi prej 2 156 580 (dy milionë e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë) lekësh, për kompensimin e pronarit të “Alba Posta”, të përballohet nga buxheti i vitit 2004, zëri “Shpronësime”, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe të Telekomunikacionit.”.

3. Pas pikës 6 të shtohet pika 6/1 me këtë përmbajtje:

“6/1. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 31.7.2004.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

REPUBLIKA E SHQIPERISE
 MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
 Drejtoria Juridike

LISTA E PRONARIT QE SHPRONESOHET PER EFEKT TE NDERTIMIT TE

SEGMENTIT RRUGOR RROGOZHINE-ELBASAN

Nr	Pronari	Numri i pasurise	OBJEKT			Shenime
			Siperfaqe e shpronesuar	Çmimi leke/m2	Vlera leke	

1	Alba Posta Sh.A Pajove	182/28	90 m2	23 962	2 156 580	
---	---------------------------	--------	-------	--------	-----------	--

Mbyllet me nr. rendor 1

VENDIM
Nr.431, datë 2.7.2004

**PËR KRITERET E GRADIMIT TË OFICERËVE, NËNOFICERËVE DHE USHTARËVE
REZERVISTË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “c” të nenit 10 të ligjit nr.9171, datë 22.1.2004 “Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ushtarakëve në rezervë, oficerë, nënoficerë dhe ushtarë rezervistë u lind e drejta e gradimit, e radhës, kur plotësojnë kriteret arsimore dhe kualifikimin e përcaktuar në këtë vendim, afatin e qëndrimit në gradë, sipas ligjit nr.9171, datë 22.1.2004 “Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, rezultatet e vlerësimeve vjetore të aktivizimit, si dhe janë në përputhje me funksionet organike, sipas nevojave të Forcave të Armatosura.

2. Kriteret arsimore dhe kualifikimi i ushtarakëve rezervistë vlerësohen si më poshtë vijon:

A. Për oficerët rezervistë:

a) Shtetasi shqiptar, që ka kryer arsimin e lartë dhe, në raste të veçanta, edhe me arsim të mesëm, që ka kryer shërbimin e detyrueshëm dhe betimin ushtarak, si dhe ka kryer, vullnetarisht, tre muaj stërvitje, në rolin e komandantit të togës, titullohet nga Ministri i Mbrojtjes oficer rezervist me gradë nëntoger.

b) Nëntogeri e fiton gradën e togerit nëse ka shërbyer 4 vjet në strukturat rezerviste dhe ka kryer një kurs kualifikimi përkatës në shkollën e trupës. Oficerët aktivë me gradën e nëntogërit (përfundimisht ata që largohen për arsye shëndetësore dhe ligjore), kur përfundojnë kontratën me Forcat e Armatosura mund të shërbejnë në strukturat e saj për një periudhë 5-vjeçare, me të njëjtën gradë.

c) Togerit për të fituar gradën e kapitenit duhet të shërbejë 5 vjet në strukturat rezerviste, pasi ka kryer kursin e komandantit të kompanisë a kursin e oficerit të shtabit të batalionit apo kurse të tjera të njësuara me to në akademitë ushtarake jashtë vendit. Oficerët aktivë që mbajnë gradën kapiten dhe nuk përparojnë në gradë apo, që për arsye joshëndetësore a ligjore, përfundojnë kontratën me Forcat e Armatosura, kalojnë oficerë rezervistë dhe mund të shërbejnë në këto struktura për një periudhë 5-vjeçare, me të njëjtën gradë.

ç) Kapiteni për të fituar gradën e majorit duhet të ketë kryer kursin themelor të oficerit të shtabit në Akademinë e Mbrojtjes “Spiro Moisiu” ose kurse të njësuara me të në akademitë ushtarake jashtë vendit. Oficerët aktivë që mbajnë gradën mujor dhe nuk përparojnë në gradë apo, që për arsye joshëndetësore a ligjore, përfundojnë kontratën me Forcat e Armatosura kalojnë oficerë rezervistë dhe mund të shërbejnë në këto struktura për një periudhë 5-vjeçare, me të njëjtën gradë.

d) Majori për të fituar gradën e nënkolonelit duhet të ketë kryer kursin e Shtabit të Përgjithshëm ose kursin e funksioneve në shtab në Akademinë e Mbrojtjes “Spiro Moisiu” a kurse të njësuara me të në akademitë ushtarake jashtë vendit. Oficerët aktivë që mbajnë gradën nënkolonel dhe nuk përparojnë në gradë apo që, për arsye joshëndetësore a ligjore, përfundojnë kontratën me Forcat e Armatosura kalojnë oficerë rezervistë dhe mund të shërbejnë në këto struktura për një periudhë 5-vjeçare, me të njëjtën gradë.

B. Për nënoficerët rezervistë:

a) Ushtari profesionist për të fituar gradën e nëntetarit duhet të ketë shërbyer të paktën 4 vjet në strukturën rezerviste, si dhe të ketë kryer, vullnetarisht, një kurs sipas specialitetit; nëntetarët aktivë që, për arsye joshëndetësore a ligjore, nuk përparojnë në gradë dhe përfundojnë kontratën me Forcat e Armatosura kalojnë si nëntetarë rezervë dhe mund të shërbejnë në këto struktura për një periudhë 4-vjeçare, me të njëjtën gradë.

b) Nëntetari, për të fituar gradën tetar, duhet të ketë kryer kursin e përgatitjes së përgjithshme për nivelin e komandantit të skuadrës në Akademinë e Nënoficerëve. Tetarët aktivë që, për arsye joshëndetësore a ligjore, nuk përparojnë në gradë dhe përfundojnë kontratën me Forcat e

Armatosura kalojnë si tetarë rezervë dhe mund të shërbejnë në këto struktura për një periudhë 4-vjeçare, me të njëjtën gradë.

c) Tetari, për të fituar gradën rreshter, duhet të ketë kryer kursin e përgatitjes së përgjithshme për nivelin e nënoficerit të togës në Akademinë e Nënoficerëve. Rreshterët aktivë që, për arsye joshëndetësore e ligjore, nuk përparojnë në gradë dhe përfundojnë kontratën me Forcat e Armatosura kalojnë si rreshterë rezervë dhe mund të shërbejnë në këto struktura për një periudhë 5-vjeçare, me të njëjtën gradë.

ç) Rreshteri, për të fituar gradën kapter, duhet të ketë kryer kursin e nënoficerit të shtabit të batalionit për sektorin ku do të shërbejë në shtab. Kapterët aktivë që, për arsye joshëndetësore e ligjore, nuk përparojnë në gradë dhe përfundojnë kontratën me Forcat e Armatosura kalojnë si kapterë rezervë dhe mund të shërbejnë në këto struktura për një periudhë 5-vjeçare, me të njëjtën gradë.

d) Kapteri, për të fituar gradën kryekapter, duhet të ketë kryer kursin e nënoficerit të shtabit të brigadës në Akademinë e Nënoficerëve. Kryekapterët aktivë që, për arsye joshëndetësore ligjore, nuk përparojnë në gradë dhe përfundojnë kontratën me Forcat e Armatosura kalojnë si kryekapterë rezervë dhe mund të shërbejnë në këto struktura për një periudhë 4-vjeçare, me të njëjtën gradë.

C. Për ushtarët rezervistë:

a) Të gjithë ushtarët që kanë përfunduar stërvitjen bazë dhe kanë shërbyer për një vit në strukturat aktive përfitojnë të drejtën e gradës ushtar rezervist profesionist I;

b) Ushtari rezervist profesionist I, për të fituar gradën ushtar profesionist II, duhet të ketë shërbyer deri në 3 vjet në strukturat rezerviste dhe të ketë kryer kursin e përparuar të specialitetit përkatës.

3. Për gradimin e radhës, kur kandidatët plotësojnë kriteret dhe janë në kushte të barabarta, komisionet e karrierës u japin përparësi ushtarakëve aktivë të dalë në rezervë në raport me ushtarakët rezervistë, që nuk kanë dalë nga strukturat aktive të Forcave të Armatosura.

4. Gradën deri në major a rreshter e fitojnë oficeri dhe nënoficeri rezervist, që kryejnë detyra në specialitetet e Forcave të Armatosura, si mjek, jurist, inxhinier, ekonomist a në funksione të ngjashme, të përcaktuara me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, sipas vjetërsisë në shërbimin ushtarak dhe jo sipas kriterëve të përcaktuara më sipër.

5. Kur oficerët rezervistë kërkojnë të përparojnë në gradë e karrierë, organet përkatëse u ofrojnë kurset e nevojshme të arsimit dhe të kualifikimit.

6. Programet e arsimit dhe të kualifikimit për përparimin në gradë të ushtarakëve rezervistë miratohen nga Ministri i Mbrojtjes, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm.

7. Shpenzimet për kurset e arsimit dhe të kualifikimit për ushtarakët rezervistë të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

8. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM
Nr.435, datë 25.6.2004

**PËR KRITERET DHE MASËN E KOMPENSIMIT TË USHTARAKUT TË FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, KUR EMËROHET OSE
KOMANDOHEM NË DETYRË JASHTË VENDBANIMIT TË TIJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 25 të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ushtarakut të Forcave të Armatosura, që, për nevoja shërbimi, emërohet me detyrë jashtë vendbanimit të tij të përhershëm dhe, në të njëjtën kohë, transferon edhe familjen, Ministria e Mbrojtjes i siguron transportin falas të familjes dhe të orendive shtëpiake, me mjetet e saj.

2. Ushtarakut arkiv të Forcave të Armatosura, që komandohet në një detyrë tjetër, jashtë vendbanimit të tij të përhershëm, dhe nuk i sigurohet transporti i përditshëm, i sigurohet fjetja në shtëpitë e ushtarakëve.

Shpenzimet e fjetjes të përballohen në masën 100 për qind nga struktura, ku ai është i komanduar.

3. Në rastet kur nuk mund t'i sigurohet fjetja në këto mjedise, ushtaraku përfiton një kompensim për fjetje, për ditët efektive të punës, të cilat paguhën sipas dokumenteve të paraqitura, por jo më tepër se 2000 (dy mijë) lekë për çdo natë.

4. Për vajtjen dhe kthimin nga familja, ushtarakut të komanduar i paguhën shpenzimet e udhëtimit, për një herë në javë, sipas dokumenteve të paraqitura, por në vlerë jo më të madhe se çmimet e miratuara për linjën përkatëse të autobusit.

5. Në rastet e fatkeqësive të personave në ngarkim të tij, ushtarakut i mundësohet udhëtimi për në familje, me mjetet e njësive apo të repartit ku është i komanduar ose i kompensohet vlera e udhëtimit.

6. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

7. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes të nxjerrë udhëzimin përkatës në zbatim të këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.438, datë 2.7.2004

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.43, DATË 17.1.1998 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR ORGANIZIMIN E PANAIREVE DHE TË
EKSPOZITAVE TREGTARE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 124 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.43, datë 17.1.1998 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

"Në këto raste merret më parë miratimi i institucioneve, që kanë në varësi këto mjedise.".

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

"2. Panaireset dhe ekspozitat tregtare, kombëtare e ndërkombëtare të organizohen në bashkëpunim me shoqëritë e specializuara për organizim panairesh, sipas një kalendarit vjetor, ku të përcaktohen lloji, koha e vendi ku ato do të zhvillohen dhe subjekti që do t'i organizojë.

Kalendari të përgatitet nga Qendra Kombëtare e Panaireset dhe të miratohet nga Ministri i Ekonomisë, brenda muajit shtator të çdo viti, për vitin pasardhës.".

3. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

"2/1. Dhomat e tregtisë dhe të industrisë, si dhe shoqatat e ndryshme të biznesit të organizojnë panaireset dhe ekspozita tregtare, kombëtare e ndërkombëtare, sipas kalendarit vjetor të përgatitur nga Qendra Kombëtare Panaireset.

Panaireset vendore të organizohen nën drejtimin e dhomave përkatëse të tregtisë dhe të industrisë, me mbështetjen e organeve të pushtetit vendor.".

4. Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

"3. Shoqëritë vendase apo të huaja, që merren me organizimin e panaireset dhe të ekspozitave tregtare, brenda muajit qershor të çdo viti të bashkëpunojnë dhe të lidhin marrëveshjet përkatëse me Qendrën Kombëtare të Panaireset për panaireset dhe ekspozitat tregtare, që ato do të organizojnë për vitin paraardhës.".

5. Pika 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

"4. Për të bashkërenduar veprimtaritë e panaireset dhe të ekspozitave tregtare ngarkohet Qendra Kombëtare e Panaireset, me cilësinë e personit juridik, publik, jobuxhetor, me seli në Tiranë, e cila është në varësi të Ministrisë së Ekonomisë. Statuti i kësaj qendre miratohet nga Ministri i Ekonomisë.".

6. Pika 5 shfuqizohet.

7. Pika 7 ndryshohet si më poshtë vijon:

"7. Ngarkohen Ministri i Ekonomisë, Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr.815, datë 10.6.2004 ka vendosur shpalljen të zhdukur të shtetasit Selim Qani Banaj.

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare;
- Rr. Qemal Stafa, kati i parë, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI NË JANAR 2004

1.	KUSHTETUTA	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

12.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
13.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000

BOTIME TË REJA

14.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
15.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600

DOLI NGA SHTYPI

PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE 1500

Doli nga shtypi më 15.7.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja Grafon
Tiranë, 2004

Çmimi 150 lekë